



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 gusht 2025
Nr. ref.: AGJ 2758/25

AKTGJYKIM

në

rastet nr. KO193/25 dhe KO196/25

Parashtrues

KO193/25, Memli Krasniqi dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

KO196/25, Hykmete Bajrami dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së

“Vendimit të Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesave

1. Kërkesa KO193/25 është dorëzuar nga Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Abelard Tahiri, Arbnore Salihu, Sala Jashari, Perparim Gruda, Eliza Hoxha, Blerta Deliu-Kodra, Elmi

Reçica, Rrahman Rama, Jakup Nura, Rashit Qalaj dhe Ganimete Musliu, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), nga Partia Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PDK), të cilët i përfaqëson Faton Fetahu, avokat në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesave).

2. Kërkesa KO196/25 është dorëzuar nga Hykmete Bajrami, Avdullah Hoti, Kujtim Shala, Fadil Hadergjona, Alban Zogaj, Krenar Xhaferi, Paris Guri, Lumir Abdixhiku, Jehona Lushaku, Arjeta Abazi dhe Armend Zemaj, deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), nga Lidhja Demokratike e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: LDK), të cilët i përfaqëson deputetja Hykmete Bajrami.

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 kontestojnë kushtetutshmërinë e *“Vendimit të Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”*.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së *“Vendimit të Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”*, për të cilin parashtruesit e kërkesave pretendojnë se nuk është në përputhshmëri me nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 74 [Ushtimi i Funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesat janë parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 korrik 2025, parashtruesit e kërkesës KO193/25 e dorëzuan kërkesën në Gjykatë. Ndërkaq, më 4 korrik 2023, parashtruesit e kërkesës KO196/25 dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë.
7. Më 7 korrik 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO193/25] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO193/25] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Radomir Laban dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, në pajtim me paragrafin 3 të rregullit 32 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] të Rregullores së punës, përmes Urdhrit [Urdh. KO193/25 dhe

KO196/25], urdhëroi bashkimin e kërkesës KO196/25 me kërkesën KO193/25. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit të lartcekur, për kërkesat e bashkuara, gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues mbetet në përbërje të njëjtë, siç është përcaktuar për kërkesën e parë, përkatësisht kërkesën KO193/25.

9. Më 9 korrik 2025, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesave dhe Urdhrin për bashkimin e tyre: (i) parashtruesit e kërkesave; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidentja); dhe (iii) Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit), të cilit iu kërkua që një kopje e kërkesës t'u dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar, më së largu deri më 11 korrik 2025. Përmes shkresave të lartcekura, Presidentja dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit u njoftuan se Presidentja dhe deputetët mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesat e parashtruesve të kërkesave, nëse kanë, deri më 11 korrik 2025.
10. Më 11 korrik 2025, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:
 - (i) Ftesën e Kryetarit të Kuvendit të Legjislaturës VIII për mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike më 8 prill 2025;
 - (ii) Transkriptin nga mbledhja e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike të 8 prillit 2025; dhe
 - (iii) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të filluar më 15 prill 2025, e vazhduar më 17,19,21,23,25,27,29 prill 2025 dhe më 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31 maj 2025 dhe më 2,4,5,7,9,11,13,15,17,19,21,23,25,27,29 qershor 2025 dhe më 1,3,5,7 dhe 9 korrik 2025.
11. Në të njëjtën ditë, deputetja Saranda Bogujevci, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje! kërkoi shtyrjen e afatit për dorëzimin e komenteve deri më 12 korrik 2025.
12. Në po të njëjtën ditë, Gjykata miratoi kërkesën e deputetes Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje!, duke e njoftuar se komentet duhet të dorëzohen deri më 12 korrik 2025.
13. Më 12 korrik 2025, deputetja Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje! dorëzoi komentet lidhur me kërkesat KO193/25 dhe KO196/25.
14. Më 14 korrik 2025, Gjykata kërkoi nga Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, që deri më 15 korrik 2025, të dorëzojë në Gjykatë procesverbalet e seancave të konstituimit të Kuvendit, ku është votuar për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, të të gjitha legjislaturave të Kuvendit nga viti 2008 e tutje.
15. Në të njëjtën ditë, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:
 - (i) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 4 dhe 9 janar 2008;
 - (ii) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 21 shkurt 2011;
 - (iii) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 17 korrik, 18 shtator dhe 8 dhjetor 2014;
 - (iv) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 3,4,10,14, 26 gusht dhe më 7 shtator 2017;

- (v) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 26 dhjetor 2019; dhe
 - (vi) Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, të mbajtur më 22 mars 2021.
16. Më 15 korrik 2025, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 për komentet e dorëzuara nga deputetja Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje!.
 17. Më 24 korrik 2025, Gjykata, njëzëri, vendosi (i) të caktojë *ex officio* masën e përkohshme përmes të cilës ndalohet çdo vendim dhe veprim i deputetëve të zgjedhur të Kuvendit lidhur me Seancën Konstituive pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor, sikurse është përcaktuar me paragrafin 2 të pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit KO124/25; (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 27 korrik 2025, në kohëzgjatje deri më 8 gusht 2025; (iii) t'ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe që (v) vendimi hyn në fuqi më 27 korrik 2025.
 18. Më 7 gusht 2025, gjyqtari Radomir Laban kërkoi përjashtimin e tij nga vendimmarrja nga rastet KO193/25 dhe KO196/25 si dhe KO215/25. Të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri, refuzoi kërkesën për përjashtim të gjyqtarit Radomir Laban.
 19. Më 7 gusht 2025, Gjykata shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi (i) të konstatojë, njëzëri, që deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e 26 qershorit 2025, të Gjykatës, në rastin KO124/25, dhe rrjedhimisht të gjitha seancat e mbajtura nga data 27 qershor deri më 26 korrik 2025 shpallen të pavlefshme; (ii) të konstatojë, njëzëri, që Kryesuesi i Seancës Konstituive të Kuvendit, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, të 26 qershorit 2025 dhe rrjedhimisht veprimet e tij janë në papajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës; (iii) të urdhërojë, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, Kryesuesin e Seancës Konstituive të Kuvendit të vazhdojë me pikën 3 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, të miratuar më 8 prill 2025, dhe në pajtim me paragrafin 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, të ftojë përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit, i/e cili/cila zgjedhet përmes votimit të hapur, votimi i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë; (iv) të urdhërojë, njëzëri të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit, që në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 74 [Ushtimi i Funksionit] të Kushtetutës gjatë procedurës së zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të jenë të pranishëm dhe të votojnë; (v) të urdhërojë, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër deputetët e zgjedhur të Kuvendit, në pajtim me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës të zgjedhin Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit sipas pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës të Seancës Konstituive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi; (vi) të vazhdojë, njëzëri, masën e përkohshme të vendosur më 24 korrik 2025 deri në hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi; (vii) t'ua kumtojë këtë Aktgjykim palëve; (viii) ta publikojë këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit për Gjykatën; dhe (ix) të konstatojë që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij nga Gjykata dhe njoftimit të palëve.

Përmbledhja e fakteve

20. Gjykata fillimisht thekson që kërkesat e parashtruesve në rastet e tanishme ndërlidhen me kërkesën KO124/25, të dorëzuar në Gjykatë nga Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë tjerë të Kuvendit.
21. Në vijim, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e kërkesave konkrete, Gjykata do të pasqyrojë shkurtimisht një përmbledhje të shkurtër të fakteve lidhur me kërkesën KO124/25.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me kërkesën KO124/25

22. Më 15 prill 2025, në ditën e 19-të pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ), Kuvendi, përmes Vendimit [nr. 01/794-2025] të 27 marsit 2025 kishte mbajtur Seancën e parë për konstituimin e Kuvendit, të kryesuar nga Kryesuesi, sipas rendit të ditës në të cilin ishte përcaktuar: (i) formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) dhënia e betimit të deputetëve; (iii) zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe (iv) zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Pas formimit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandatave të Deputetëve, u vendos në votim Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandatave të Deputetëve, i cili raport nuk kaloi, për shkak se 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë votuan për, 46 (dyzet e gjashtë) kundër dhe 11 (njëmbëdhjetë) abstenuan. Si rezultat, më 17 prill 2025, seanca u ndërpre për ta vazhduar brenda 48 (dyzet e tetë) orëve për shkak se në takimin konsultues nuk ishte arritur konsensus. Më 19 prill 2025, vazhdoi seanca konstituive, ku (i) pasi Kryesuesi vendosi në votim formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe Mandatave të Deputetëve me përbërje të njëjtë, i njëjti u votua nga 120 (njëqind e njëzet) deputetë të Kuvendit; (ii) Komisioni i Përkohshëm paraqiti raportin me të cilin konstatoi vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe i njëjti u miratua në mënyrë unanime; dhe (iii) të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre. Në po të njëjtën ditë, pas kërkesës së Kryesuesit drejtuar Lëvizjes Vetëvendosje! që ta propozojë kandidatin për Kryetar/e të Kuvendit, kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu, propozim i cili nuk kaloi gjatë votimit të zhvilluar dy herë. Më pas, seanca konstituive kishte vazhduar më 21, 23, 25, 27 dhe 29 prill 2025, në të cilat seanca propozimi për Kryetare të Kuvendit ishte i njëjtë dhe nuk arriti votat e nevojshme nga deputetët. Tutje, nga 1 maji 2025 e deri në publikimin e Aktgjykimit në rastin KO124/25, Kuvendi vazhdoi me mbajtjen e seancave të vazhdueshme për konstituim, gjatë të cilave Kryesuesi kërkoi nga partitë politike që të propozojnë nga 1 (një) anëtar për Komisionin për Votim të Fshtë, propozim i cili nuk arriti votat e nevojshme, duke rezultuar në mos-konstituimin e Kuvendit.
23. Më 26 qershor 2025, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO124/25, me parashtrues të kërkesës Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së *“Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar “transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025”*, konstatoi që:
 - (i) Seanca e Konstituimit të Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar dhe si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të

Republikës së Kosovës e njëjta nuk është zhvilluar në pajtim me përcaktimet dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës; dhe

- (ii) deputetët e zgjedhur të Kuvendit, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkrjetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funkcionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Aktgjykimin duhet që sa më shpejtë dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë të përfundojnë seancën konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me kërkesat KO193/25 dhe KO196/25

- 24. Më 27 qershor 2025, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 100 (njëqind) deputetë. Kryesuesi, pas konsultimit me përfaqësuesit e subjekteve politike, njoftoi deputetët që, marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, të njëjtit u pajtuan që seanca të ndërpritet deri sa të përfundojë takimi me liderë politikë i ftuar nga subjekti më i madh politik dhe që Seanca Konstituive e Kuvendit të vazhdojë më 29 qershor 2025, në orën 11:00.
- 25. Më 29 qershor 2025, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 95 (nëntëdhjetë e pesë) deputetë. Kryesuesi kërkoi nga partitë politike të propozojnë nga 1 (një) deputet për anëtar të Komisionit për Votim të Fshtetë, propozim i cili pas vendosjes në votim mori 53 (pesëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kryesuesi ndërpreu seancën dhe njoftoi deputetët për vazhdimin e seancës më 1 korrik 2025, në orën 11:00.
- 26. Seanca Konstituive vazhdoi më 1 korrik 2025, me ç'rast, pasi që Kryesuesi konstatoi që në sallë janë 100 (njëqind) deputetë, kërkoi përsëri nga partitë politike të propozojnë anëtarët për Komisionin për Votim të Fshtetë, propozim i cili pas vendosjes në votim mori 51 (pesëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kryesuesi ndërpreu seancën dhe njoftoi deputetët për vazhdimin e seancës më 3 korrik 2025, në orën 11:00.
- 27. Më 3 korrik 2025, vazhdoi Seanca Konstituive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 99 (nëntëdhjetë e nëntë) deputetë. Kryesuesi kërkoi nga partitë politike të propozojnë nga 1 (një) deputet për anëtar të Komisionit për Votim të Fshtetë, propozim i cili pas vendosjes në votim mori 54 (pesëdhjetë e katër) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kryesuesi ndërpreu seancën dhe njoftoi deputetët për vazhdimin e seancës më 5 korrik 2025, në orën 11:00.
- 28. Pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25, Kuvendi vazhdoi me mbajtjen e seancave për konstituimin e Kuvendit më 27 qershor, 29 qershor, 1 korrik, 3 korrik, 5 korrik, 7 korrik, 9 korrik, 11 korrik, 13 korrik, 15 korrik, 17 korrik, 19 korrik, 21 korrik dhe 23 korrik 2025, gjatë të cilave deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk përfunduan seancën konstituive të Kuvendit për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.
- 29. Më 22 korrik 2025, Presidentja e Republikës së Kosovës, parashtroi në Gjykatë kërkesën për “*ulerësimin e konfliktit në mes të kompetencave kushtetuese sipas nenit 113 (3)(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”, e regjistruar në Gjykatë me numër KO215/25.

30. Më 24 korrik 2025, Gjykata, njëzëri, vendosi (i) të caktojë *ex officio* masën e përkohshme përmes të cilës ndalohet çdo vendim dhe veprim i deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me Seancën Konstituive pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor, sikurse është përcaktuar me paragrafin 2 të pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit KO124/25; (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 27 korrik 2025, në kohëzgjatje deri më 8 gusht 2025; (iii) t'ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe që (v) vendimi hyn në fuqi më 27 korrik 2025.
31. Më 25 dhe 26 korrik 2025, Kuvendi vazhdoi me mbajtjen e seancave për konstituimin e Kuvendit gjatë të cilave deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk përfunduan seancën konstituive të Kuvendit për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.

Pretendimet e parashtresve të kërkesave

32. Parashtresit e kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 pretendojnë se: "*Vendimi i Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.*" është nxjerrë në kundërshtim me nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], 74 [Ushtimi i Funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
33. Në vijim, Gjykata fillimisht do të pasqyrojë pretendimet e parashtresve të kërkesës KO193/25 dhe më pas do të vazhdojë me përmbledhjen e pretendimeve të parashtresve të kërkesës KO196/25.

(i) Pretendimet e parashtresve të kërkesës KO193/25

34. Parashtresit e kërkesës KO193/25 theksojnë se seancat konstituive të 29 qershorit 2025 si dhe të 1 dhe 3 korrikut 2025, në të cilat është kërkuar propozimi i anëtarëve për Komisionin për Votim të Fshtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, nuk janë zhvilluar në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, duke rezultuar në shkelje të gjetjeve dhe udhëzimeve shprehimore të ofruara përmes Aktgjykimit.
35. Në këtë drejtim, parashtresit e kërkesës KO193/25 shtojnë se çështja e Komisionit për Votim të Fshtë është trajtuar në mënyrë shteruese dhe se Gjykata: "*në kontekst të shqyrtimit të kërkesës kishte konstatuar se:*

-Rendi i ditës i seancës konstituive është i pandryshueshëm dhe nuk mund të ndryshohet pas fillimit të seancës konstituive;
- Se nuk ka të drejtë askush të vendosë votim të fshtë pa bazë kushtetuese;
- Rendi i ditës i seancës konstituive është i përcaktuar në par. 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit dhe përbën përmbajtjen kryesore dhe të vetme të seancës konstituive, të cilës duhet t'i përmbahet me përpikmëri Kryesuesi i seancës konstituive;
-Kushtetuta nuk përcakton mënyrën e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit;"
36. Më tej, parashtresit e kërkesës KO193/25 pretendojnë që mocionet procedurale nuk janë të zbatueshme për seancën konstituive por vetëm për seancat e zakonshme plenare. Sipas parashtresve të kërkesës, "*mos nënshtrimi i procedurave të zakonshme parlamentare*", nënkupton pamundësinë juridike që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet/ndryshohet,

ngase siç përcaktohet në par. 178 të aktgjykimit relevant, çështja e mënyrës së votimit në seancën konstituive, përkatësisht nëse e njëjta duhet të jetë e hapur apo e fshehtë, nuk është përcaktuar as në dispozitat kushtetuese dhe as në kreun IV të Rregullores së Kuvendit.”.

37. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës KO193/25 shtojnë se: “Rrjedhimisht, gjykata ka konstatuar në mënyrë të qartë dhe të saktë se dispozitat që rregullojnë mbajtjen e seancës konstituive, nuk përmbajnë asnjë referencë në nenin 53 (ndryshimi i rendit të ditës), nenin 57 (mocionet procedurale) si dhe nenin 122 (interpretimi i Rregullores së Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, duke vlerësuar në këtë mënyrë se objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i këtyre tre (3) neneve të Rregullores së Kuvendit rregullojnë çështje të tjera të jetës parlamentare dhe të njëjtat nuk mund të aplikohen për qëllime të procedurës së seancës konstituive, në mungesë të përcaktimit/referimit ndaj të njëjtave të kreut IV të Rregullorës së Kuvendit.”.
38. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se, përmes Aktgjykimit në rastin KO124/25, Gjykata i është referuar zgjedhjes së Presidentit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si raste në të cilat aplikohet mënyra e votimi të fshehtë. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës KO193/25 pretendojnë se mënyra e votimit të fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit nuk parashihet fare në Kushtetutë dhe se “[...], jo rastësisht zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit në bazë të praktikës së mëparshme është bërë vetëm përmes votimit të hapur, ngase neni 67.2 i Kushtetutës nuk e përmban ndonjë kusht të tillë kushtetues – për propozimin e dy ose më shumë kandidatëve, por është kufizuar vetëm në propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit nga grupi më i madh parlamentar.”. Sipas parashtruesve të kësaj kërkesë “fakti se Kushtetuta nuk e përcakton një mënyrë të fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe mbi të gjitha fakti se kreu IV i Rregullores së Kuvendit – si baza e vetme juridike mbi të cilën organizohet procesi i votimit në këtë organ - nuk e përcakton, po ashtu, një mënyrë të tillë votimi - zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit duhet të bëhet duke marrë për bazë vetëm praktikën e mëparshme të konstituimit të Kuvendit.”.
39. Tutje, parashtruesit e kërkesës KO193/25 pretendojnë se vendimi i kontestuar është jokushtetues, si rezultat i shkeljes së dispozitave të cekura në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, pasi në kuptim të paragrafit 6 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, ka pamundësuar që Kuvendi të ushtrojë kompetencën e tij për të zgjedhur Kryetarin e Kuvendit. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me paragrafin 108 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO119/14.
40. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës KO193/25 pretendojnë se ““zhvillimi” dhe “përfundimi” i seancës konstituive është pamundësuar ekskluzivisht si rezultat i vendimit të kryesuesit të seancës, e para, për të kërkuar nga subjektet politike propozimet për anëtar të Komisionit për Votim të Fshehtë, e dyta, për të hedhur në votim, e treta, për të votuar Komisionin për Votim të Fshehtë, dhe e katërta, për të ndërprerë seancën në mënyrë arbitrare, pas moskalimit, respektivisht mosmiratimit të procedurës për votim në mënyrë të fshehtë.”. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se veprimet e lartcekura të Kryesuesit të seancës konstituive janë në shpërputhje të plotë me udhëzimet e Gjykatës dhe paraqesin devijim të rendit të ditës, të paracaktuar paraprakisht dhe shprehimisht në paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit.

41. Më tej, parashtuesit e kërkesës pretendojnë se procedura e votimit të Komisionit për Votim të Fshehtë nga deputetët është në kundërshtim me nenin 74 [Ushtimi i Funksionit] të Kushtetutës me arsyetimin se deputetët të cilët kanë votuar një propozim të tillë, në shpërputhje me rendin e ditës së seancës konstituive, nuk e kanë ushtruar funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Për më tepër, sipas parashtuesve të kërkesës *“veprimi arbitrar i Kryesuesit të seancës për ndërprerjen e vazhdimit të seancës konstituive, pas dështimit të themelimit të Komisionit të lartcekur, përbën akt kundërkushtetues të tij, ngase në këtë mënyrë i'u ka pamundësuar deputetëve të Kuvendit që të ushtrojnë funksionin e tyre në “interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit”, veprim i cili qartazi ishte në shpërputhje me par. 4 të nenit 8 të Rregullorës së Kuvendit, si dhe par. 155, 165, 178, 179, 182 dhe 187 të aktgjykimit relevant.”*.
42. Parashtuesit e kërkesës KO193/25 konsiderojnë se, në mungesë të rregullimit me Kushtetutë të mënyrës së votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, seanca konstituive duhet të zhvillohet vetëm mbi bazën e paragrafit 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, si dhe mbi bazën e praktikave të mëparshme të Kuvendit. Në lidhje me këtë, parashtuesit e kërkesës shtojnë se vazhdimi i seancës konstituive më 29 qershor dhe më 1 dhe 3 korrik 2025 ka vazhduar në mënyrë të gabuar dhe shkeljet e lartcekura kushtetuese janë përsëritur në mënyrë të njëjtë.
43. Parashtuesit e kërkesës pretendojnë se *“pamundësia e realizimit të suksesshëm të seancës konstituive, respektivisht e zgjedhjes së Kryetarit dhe Nënkryetarëve të Kuvendit, ndërlidhet ekskluzivisht me keqinterpretimin dhe moskonceptimin e drejtë dhe të plotë të gjetjeve dhe udhëzimeve të aktgjykimit relevant nga grupi më i madh parlamentar (në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje) dhe Kryesuesi i seancës konstituive (i cili është edhe deputet i këtij grupi parlamentar), të cilët propozimin e votimit të fshehtë dhe/apo Komisionit për Votim të Fshehtë, që do të administronte një procedurë të tillë votimi, e kanë shndërruar në mjet për bllokimin e konstituimit të Kuvendit.”*.
44. Në këtë aspekt, parashtuesit e kërkesës KO193/25 theksojnë se neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës ka përcaktuar në mënyrë të ndarë procesin e zgjedhjes së Kryetarit nga procesi i zgjedhjes së Nënkryetarëve. Sipas parashtuesve të kërkesës, grupi më i madh parlamentar është duke e bllokuar në vazhdimësi konstituimin e Kuvendit, me pretendimin se detyrimi për ta zgjedhur Kryetarin e Kuvendit i takon të gjithë deputetëve dhe jo grupit më të madh parlamentar. Lidhur me këtë, parashtuesit e kërkesës pretendojnë se *“ndonëse par. 2 i nenit 67 të Kushtetutës, në mënyrë të qartë ka përcaktuar dy (2) elemente të pandashme për sa i takon zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit (1. Të drejtën e grupit parlamentar për t'a propozuar Kryetarin e Kuvendit; 2. Kushtin që kandidati i propozuar të zgjedhet me shumicën e votave të të gjitha deputetëve të Kuvendit të Kosovës), në rrethanat e rastit konkret, grupi më i madh parlamentar edhe pas publikimit të aktgjykimit relevant, është duke vepruar në shpërfillje shqetësuese dhe tepër serioze ndaj detyrimit që i njëjti e ka “për bashkëpunim në mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare, për t'a gjetur konsensusin apo kompromisin e nevojshëm, në mënyrë që kjo e drejtë në asnjë mënyrë të mos rezultoj në bllokimin e konstituimit të Kuvendit.”*.
45. Parashtuesit e kërkesës KO193/25, duke iu referuar paragrafëve 130, 185 dhe 190 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25, theksojnë se konstatimet e Gjykatës ndërlidhen me *“detyrimin që e ka vetëm grupi më i madh parlamentar për të siguruar*

(përmes konsensusit dhe kompromisit ndaj grupeve të tjera parlamentare), shumicën e nevojshme të deputetëve për të zgjedhur Kryetarin e Kuvendit, në mënyrë që kjo e drejtë të mos vazhdojë të shndërrohet si mjet bllokimi për konstituimin e Kuvendit.”. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se tendenca e grupit më të madh parlamentar për të barazvlerësuar procesin e zgjedhjes së Kryetarit me procesin e zgjedhjes së Nënkryetarëve, është tërësisht e pabazë, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe vetë gjetjet e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës, pasi sipas parashtruesve të kërkesës “pa asnjë mëdyshje është bërë e qartë se detyrimi për grupet e tjera parlamentare vlen vetëm në raport me zgjedhjen e Nënkryetarëve të Kuvendit, zgjedhja e të cilëve nuk kërkon as kompromis, e as konsensus, por kufizohet vetëm në bashkëpunim dhe konsultime konstruktive për të propozuar dhe votuar kandidatët për nënkryetar, zgjedhja e të cilëve assesi nuk mund të bllokohet, ngase votimi për zgjedhjen e tyre është i përbashkët dhe jo individual. [...]”.

46. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës KO193/25 e konsiderojnë të domosdoshme që Gjykata të ofroj një sqarim shterues dhe përfundimtar në raport me detyrimet e qarta të grupeve parlamentare për zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkryetarëve të Kuvendit dhe që, marrë në konsideratë afatin 30 ditor për përfundimin e seancës konstituive të Kuvendit, Gjykata, me urgjencë, të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar dhe që nga ana tjetër të sigurohet afati i arsyeshëm për të konstituuar Kuvendin jo më larg se brenda afatit të lartcekur.
47. Në fund, parashtruesit e kërkesës KO193/25 kërkojnë që Gjykata (i) të shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të shpallë se Vendimi i Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimin të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas Transkriptit të datës 29 qershor 2025 është në kundërshtim me Kushtetutën; (iii) të shpallë Vendimin e Kuvendit për ndërprerjen e seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas Transkriptit të datës 29 qershor 2025, në kundërshtim me Kushtetutën; (iv) të urdhëroj Kuvendin për vazhdimin e Seancës Konstituive (zgjedhjen e Kryetarit) deri në realizimin e suksesshëm dhe të plotë të saj, vetëm mbi bazën e praktikave të mëparshme të konstituimit të Kuvendit, përmes votimit të hapur; dhe (v) të konstatojë se dështimi në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe apo Nënkryetarëve të Kuvendi nuk shkakton mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare.

(ii) Pretendimet e parashtruesve të kërkesës KO196/25

48. Parashtruesit e kërkesës KO196/25 pretendojnë se Kryesuesi i Seancës Konstituive me rastin e Vendimit për formimin e Komisionit për Votim të Fshehtë lidhur me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, në seancën e 29 qershorit 2025, dhe pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës ka shkelur dispozitat kushtetuese duke mos respektuar Aktgjykimin e Gjykatës të 26 qershorit 2025 në rastin KO124/25.
49. Parashtruesit e kërkesës lidhur me propozimin e Kryesuesit specifikojnë që: *“Edhe pse një propozim i tillë ishte rrëzuar, duke mos u miratuar, Kryesuesi i seancës, në mënyrë kundër kushtetuese, duke shkelur dispozitat e kushtetutës dhe duke vepruar në kundërshtim me konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, i kishte ndërprerë punimet e Kuvendit për vazhdimin e seancës konstituive dhe seancën e kishte shtyrë për datën 1 korrik 2025. Rrjedhimisht, propozimi dhe votimi për Komisionin për Votim të Fshehtë si dhe ndërprerja arbitrare e seancës nga ana e Kryesuesit të Seancës, ishte në kundërshtim nenin 65 (6), nenin 67 par.7 (2), nenin 74 dhe nenin 76 të Kushtetutës.”*

50. Sipas parashtruesve të kërkesës Aktgjykimi në rastin KO124/25 “në disa pika kishte konstatuar mënyrën e organizimit të Seancës konstituive, duke përfshirë qartësimin që rendi i ditës në seancë konstituive nuk mund të ndryshohet, nga rendi i ditës i përcaktuar nga fillimi i seancës së parë, ashtu siç është përcaktuar edhe në mënyrë taksative në Rregulloren e Kuvendit.” Për pasojë, parashtruesit e kërkesës argumentojnë që “Gjykata Kushtetuese e ka definuar që rendi i ditës është i pandryshueshëm nga rendi i ditës i përcaktuar në fillimin e seancës konstituive, Kryesuesi i Seancës, nuk ka të drejtë që të veprojë ndryshe, edhe sikur të kishte vullnet politik për ndryshimin e pikave të rendit të ditës. Kjo për faktin se vullneti politik hyn në funksion të arritjes së marrëveshje politike për themelimin e institucioneve pas zgjedhjeve nacionale, por në asnjë rast nuk mund të ndërhyj në procedurat e përcaktuara me dispozitat kushtetuese dhe dispozitat e Rregullores së Kuvendit, derisa të njëjtat janë në fuqi. Vullneti politik në të ardhmen mund të orientohet në ndryshime edhe kushtetuese, ligjore dhe të rregullave të përcaktuara me Rregullore të Kuvendit, por asesi që ky vullnet të realizohet duke shkelur procedurat parlamentare derisa ato janë në fuqi.”
51. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë që: “Secili subjekt parlamentar, që voton formimin e Komisionit për Votim të Fshehtë, do të bënte shkelje kushtetuese, rrjedhimisht do të rrezikojë funksionimi demokratik i institucionit me të lartë përfaqësues dhe ligjvënës në shtetin tonë. Prandaj, në këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duhet të shterojë shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe të nxjerr konstatime edhe më të qartësuar duke e miratuar kërkesën tonë me pikat e propozuara në dispozitiv të Aktgjykimit për këtë rast, pasi që po vërehet qartë tendenca e Kryesuesit të Seancës dhe të subjektit të tij politik, që të mundohen të keqinterpretojnë konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese për këtë rast.”
52. Në vijim, parashtruesit e kërkesës argumentojnë që Gjykata Kushtetuese duhet të trajtojë edhe rolin e Kryesuesit të Seancës në rastet kur i njëjti ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës gjatë ushtrimit të mandatit/rolit të tij të udhëheqjes së seancës konstituive, sidomos në rastin kur ka një Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, i cili i ka dhënë konstatimet dhe udhëzimet e nevojshme të respektimit të rendit të ditës së seancës konstituive në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës së Kuvendit. Në lidhje me këtë, ata specifikojnë që “duhet të krijohen mundësi që seanca të zhvillojë punimet në pajtim me rendin e ditës së seancës konstituive, duke i dhënë mundësinë, që deputetet të votojnë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, si dy pika të ndara të rendit të ditës, duke i hapur rrugë themelimit të institucioneve pas zgjedhjeve parlamentare.”
53. Tutje, parashtruesit e kërkesës vlerësojnë që neni 53 (ndryshimi i rendit të ditës), neni 57 (mocionet procedurale) dhe neni 122 (interpretimi) i Rregullores së Kuvendit nuk mund të aplikohen në seancë konstituive, por të njëjtat aplikohen vetëm në seanca të rregullta parlamentare, sepse, sipas tyre “rendi i ditës së seancës konstituive është i përcaktuar në mënyrë taksative me Rregullore të Kuvendit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës të Kosovës.”
54. Në vijim të elaborimit të pretendimeve të tyre, parashtruesit e kërkesës theksojnë që: “Zhvillimi i seancës konstituive është pamundësuar arbitrarisht si rezultat i vendimit të kryesuesit të seancës, e para, për të ndryshuar rendin e ditës së seancës konstituive duke kërkuar nga subjektet politike propozimet për anëtar të Komisionit për Votim të Fshehtë, e dyta, duke hedhur në votim për të votuar për Komisionin për Votim të Fshehtë edhe pa pasur propozime nga shumica e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvend, dhe e

treta, për të ndërprerë seancën në mënyrë arbitrare, pas moskalimit, respektivisht mosmiratimit të procedurës për votim në mënyrë të fshehtë, duke ua pamundësuar deputetëve votimin për Kryetar të Kuvendit.”

55. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që veprimet e Kryesuesit të Seancës konstituive të Kuvendit janë në kundërshtim të plotë me dispozitat kushtetuese si dhe me udhëzimet dhe gjetjet e Gjykatës Kushtetuese dhe për më tepër paraqesin devijimi të rendit të ditës, të paracaktuar paraprakisht, sipas paragrafit 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, e cila Rregullore sipas tyre në kuptim të nenit 76 të Kushtetutës, përbën aktin më të lartë, në të cilën përcaktohet organizimi i brendshëm dhe mënyra e punës së Kuvendit.
56. Parashtruesit e kërkesës po ashtu argumentojnë që ndërprerja e vazhdimit të Seancës konstituive, pas dështimit të themelimit të Komisionit për votim të fshehtë, përbën *“akt kundërkushtetues të tij, ngase në këtë mënyrë ju ka pamundësuar deputetëve të Kuvendit që të ushtrojnë funksionin e tyre “në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit”*. Si rrjedhojë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që veprimet e Kryesuesit janë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, si dhe paragrafët 155, 165, 178, 179, 182 dhe 187 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25.
57. Në vijim, parashtruesit e kërkesës specifikojnë se neni 67 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve) i Kushtetutës, qartazi e ka përcaktuar në mënyrë të ndarë procesin e zgjedhjes së Kryetarit, nga procesi i zgjedhjes së nënkryetarëve, si dhe detyrimet e grupeve parlamentare në raport me procesin zgjedhor të tyre. Sipas tyre paragrafi 2 i nenit 67 të Kushtetutës, në mënyrë të qartë *“ka përcaktuar dy (2) elemente të pandashme për sa i takon zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit. (1. Të drejtën e grupit parlamentar për t’a propozuar Kryetarin e Kuvendit; 2. Kushtin që kandidati i propozuar të zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës), në rrethanat e rastit konkret, grupi më i madh parlamentar edhe pas publikimit të aktgjykimit relevant, është duke vepruar në shpërfillje ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese “për bashkëpunim në mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare, për t’a gjetur konsensusin apo kompromisin e nevojshëm, në mënyrë që kjo e drejtë në asnjë mënyrë të mos rezultojë në bllokimin e konstituimit të Kuvendit”*.”
58. Në vijim të kësaj, parashtruesit e kërkesës argumentojnë që: *“[...]tendenca e vazhdueshme e grupit më të madh parlamentar për të konsideruar si proces të njëjtë politik dhe procedural të procesit të zgjedhjes së Kryetarit, me procesin e zgjedhjes së Nënkryetarëve të Kuvendit, është tërësisht e pabazë, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit është përfaqësues i institucionit të Kuvendit dhe i njëjti kur të zgjidhet përfaqëson Kuvendin, ndërsa nënkryetarët e Kuvendit janë përfaqësues politik të grupeve me të mëdha parlamentare të cilët i adresojnë qëndrimet e grupeve politike në organet e Kuvendit të Republikës dhe të njëjtit zgjedhën me një votim të përbashkët si përfaqësues direkt të grupeve parlamentare.”* Në këtë kuptim, parashtruesit e kërkesës vlerësojnë që *“neni 67 i Kushtetutës, procesin e zgjedhjet së Kryetarit e ka ndarë nga procesi i zgjedhjes së Nënkryetarëve. Propozimi, votimi dhe zgjedhja e tyre, është e ndarë, e veçantë dhe e pakushtëzuar nga njëra tjetra. Prandaj, si e tillë është esenciale të sqarohet nga ana e gjykatës, në mënyrë që të evitoj çfarëdo tendence të politikës bllokuese e cila ka për qëllim shkrirjen në një pikë të rendit të ditës së zgjedhjes së Kryetarit dhe të Nënkryetarëve të Kuvendit.”*

59. Tutje, dhe lidhur me paragrafin 145 të Aktgjykimit në rastin KO124/25, përmes të cili konstatohet që Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës” parashtuesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të “[...] sqarojë rrethanat kur Kuvendi nuk arrinë të konstituohet brenda agatit prej 30 ditëve, cilat janë veprimet që duhet të ndërmerren dhe cili është roli i institucioneve tjera, në rastin konkret i Presidentit të Republikës, si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve.”
60. Në fund, parashtuesit e kërkesës ritheksojnë që “vendimi i Kuvendit të Kosovës për votimin e Komisionit për Votim të Fshehtë, në kuadër të vazhdimisht të Seancës Konstitutive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025, e ndërlidhur me ndryshimin e rendit të ditës të seancës konstitutive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar me datën 15 prill 2025,” është në kundërshtim pikën 6 të nenit 65, pikën 2 të paragrafit 7 të nenit 67, nenin 74 dhe nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
61. Përfundimisht, parashtuesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: (i) të deklarojnë kërkesën e pranueshme; (ii) të shpallë ” Vendimin e Kuvendit për Votimin e Komisionit për Votim të Fshehtë, në kuadër të vazhdimisht të Seancës Konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas Transkriptit të datës 29 qershor 2025, në kundërshtim me nenin 65 pika 6, nenin 67 pika 7 (2), nenin 74 dhe nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” (iii) të shpallë “Vendimin e Kuvendit për ndërprerjen e seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas Transkriptit të datës 29 qershor 2025, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”; dhe (iv) të urdhërojë “Kryesuesin e Seancës konstituive që të zhvilloj punimet e seancës në pajtim me nenin 65 pika 6, nenin 67 pika 7 (2), nenin 74 dhe nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas propozimit të rendit të ditës në fillim të seancës konstituive, me votim të hapur”

Komentet e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje!

62. Më 12 korrik 2025, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje!, të përfaqësuar nga deputetja Saranda Bogujevci dorëzuan në Gjykatë komentet ndaj pretendimeve të parashtuesve të kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së “Vendimit të Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimisht të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”.
63. Fillimisht, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! pretendojnë se parashtuesit e kërkesave kanë keqkuptuar dhe keqinterpretuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25. Lidhur me këtë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se “Megjithëse Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KO124/25 gjeti se Seanca Konstituive përbën akt kushtetues, ajo me të drejtë nuk i gjeti si akte të miratuara nga Kuvendi “Vendimin për Votimin e Komisionit për Votim të Fshehtë në kuadër të vazhdimisht të Seancës Konstituive të Legjislaturës IX, të mbajtur sipas Transkriptit të të mishëruara në procesverbalet e vazhdimëve të Seancës Konstituive”. Në mungesë të akteve të miratuara nga Kuvendi, qoftë edhe vendim të natyrës negative me të cilin refuzohet votimi i Komisionit për votim të fshehtë, pavarësisht formës të shkruar ose jo, Gjykata Kushtetuese nuk gjykoi pretendimet e

parashtruesve në rastin nr. KO124/25, sepse nuk kishte asnjë akt të miratuar nga Kuvendi. Këtë nuk po e themi domosdoshmërisht për të kontestuar pranueshmërinë e këtyre kërkesave, por për ta sqaruar deri në fund procesin dhe procedurën vendimmarrëse në Kuvendin e Kosovës, përfshirë faktin që Kuvendi në mungesë të kuorumit, praktikisht refuzimit të një pjese të deputetëve të betuar për të marrë pjesë në votim, nuk po arrin të marrë asnjëlloj vendim. Pra, nuk ekziston asnjë vendim as i shkruar e as i pashkruar për themelimin e Komisionit për votim të fshehtë, as apo kundër tij, nuk ekziston as vendimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit me votim të hapur e as me votim të fshehtë. Po ashtu nuk ekziston vendimi as për moszgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit. Vetëm ndonjë nga këto vendime ose disa prej tyre bashkë do të prodhonin edhe në kuptimin material vendim/e të Kuvendit, me pasojë juridike dhe me objekt të qartë për vlerësimin eventual të kushtetutshmërisë së tyre. Për këtë çështje Kushtetuta përcakton qartë në nenin 113, paragrafi 5 se një nga kushtet e pranueshmërisë së kërkesës për shqyrtimin e kushtetueshmërisë është që akti duhet të jetë i miratuar nga Kuvendi. Akt të tillë nuk ka për këtë proces si rrjedhim edhe aktivizimi i nenit 113, paragrafi 5 nuk është i lejueshëm në këtë fazë.”

64. *Më tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje!, duke iu referuar paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, shtojnë se, sipas tyre, Gjykata nuk ka të drejtë të bëjë interpretimin e mendimeve, qëndrimeve dhe sjelljes së deputetëve gjatë vijimit të seancës konstituive, por vetëm të akteve formale të votuara në Kuvend. Në këtë drejtim, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! nënvizojnë se “Nga kërkesat e parashtruesve, krijohet bindja që parashtruesit po pretendojnë për kontroll kushtetues preventiv për një proces nga i cili nuk ka të miratuar ndonjë akt, sepse një pjesë e deputetëve të pranishëm në seancë nuk e kanë kryer obligimin e tyre kushtetues për të marrë pjesë në votim, siç përcaktohet në Aktgjykimet KO119/14 dhe KO124/25.”*
65. *Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se parashtruesit e kërkesave nuk e kanë qartësuar cili është akti që kontestohet dhe cilën pasojë po e parandalojnë pasi që votimi për komisionin e fshehtë dhe zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit nuk ka ndodhur. Sipas deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje!, “Parashtruesit i kanë të gjithë mekanizmat e mundësitë, pra rrugën kushtetuese të kontestimit, duke mundësuar miratimin e aktit të Kuvendit paraprakisht, qoftë votimin e komisionit, e qoftë zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, për të kërkuar pastaj eventalisht vlerësimin e kushtetutshmërisë së votimit të Komisionit apo të zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit qoftë për nga procedura, qoftë për nga përmbajtja.”*
66. *Më tej, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! konsiderojnë se Gjykata përmes Aktgjykimit të rastin KO124/25 ka përcaktuar që deputetët duhet të kontribuojnë në konstituimin e Kuvendit duke qenë konstruktiv me pjesëmarrje në votim dhe nuk mund të lirohen nga ky detyrim. Në këtë aspekt, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se parashtruesit e kërkesave nuk marrin pjesë në votim dhe nuk propozojnë ndonjë rrugë për të shkuar drejt konstituimit të Kuvendit.*
67. *Përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesave lidhur me mënyrën e votimit, Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se “Përprjekja e parashtruesve për ta përjashtuar mundësinë e votimit të fshehtë si mënyrë votimi për kryetarin e Kuvendit, shembet tërësisht përballë dy konstatimeve të qarta dhe të pakontestueshme të Gjykatës në aktgjykimin e rastit KO124/25. Së pari, Gjykata ka vërejtur se Kushtetuta, jo vetëm që nuk parasheh votim të fshehtë për kryetarin e Kuvendit, por nuk e parasheh as votim të hapur: “Gjykata thekson që çështja e mënyrës së votimit në Seancën Konstituive,*

përkatësisht nëse e njëjta duhet të jetë në mënyrë të hapur apo të fshehtë nuk është përcaktuar as me dispozitat kushtetuese dhe as në Kreun IV të Rregullores së Kuvendit" (par. 178, theks i shtuar). Sipas logjikës së parashtruesve, pra, a duhet të nxirret përfundimi që as votimi i hapur, as votimi i fshehtë, nuk është i lejueshëm, sepse të dyja janë "pa bazë kushtetuese"? Sigurisht që jo. Së dyti, të dy aktgjykimet e Gjykatës, në rastet KO124/25 dhe KO119/14, përsërisin disa herë se votimi i fshehtë, si mënyrë votimi, është i pranueshëm jo vetëm për zgjedhjen e presidentit dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por edhe, shprehimisht e posaçërisht, për konstituimin e Kuvendit: "Në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë" (KO124/25, par. 180, theks i shtuar, duke iu referuar aktgjykimet të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO119/14, par. 128). Përkundër pretendimit të parashtruesve, pra, Gjykata ka konstatuar shprehimisht se votimi i fshehtë është opsion i pranueshëm edhe në konstituimin e Kuvendit".

68. Gjithashtu, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se: "Qëllimi i Gjykatës, qartazi, ishte konstatimi se, përderisa Kushtetuta është e heshtur sa i përket mënyrës së votimit në konstituimin e Kuvendit, atëherë të dy mënyrat, edhe votimi i hapur, edhe votimi i fshehtë, janë të pranueshme dhe se zgjedhja e mënyrës së duhur është çështje në diskrecionin e vetë deputetëve për ta vendosur. Pikërisht për këtë arsye, Gjykata thekson që: "Se çka konsiderojnë deputetët se është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në aspekt politik dhe në aspekt të politikave publike, është tërësisht në dorën e deputetëve të Kuvendit. Përderisa respektohet Kushtetuta, çdo zgjidhje e të zgjedhurve dhe njëkohësisht përfaqësuesve të popullit, duhet respektuar" (KO124/25, par. 181, duke iu referuar aktgjykimet të rastit KO72/20, par. 357, theks i shtuar)".
69. Duke iu referuar paragrafit 185 të Aktgjykimet të Gjykatës në rastin KO124/25, deputetët e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, pretendojnë se votimi i fshehtë nuk është as i detyrueshëm, as i ndaluar, por është i lejueshëm si një kompromis i mundshëm mes deputetëve, me qëllim të konstituimit të Kuvendit.
70. Në këtë drejtim, përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, deputetët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! theksojnë se propozimi i kryesuesit për formimin e Komisionit për votim të fshehtë paraqet një përpjekje të sinqertë për të gjetur "kompromisin apo konsensusin" e nevojshëm për mënyrën e votimit, me qëllim që të zgjidhet Kryetari i Kuvendit si hap i domosdoshëm për konstituimin e Kuvendit, në përputhje me nënparagrafin 4.3 të paragrafit 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit.
71. Deputetët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! kërkojnë që Gjykata: "(1) t'i ritheksojë konstatimet e aktgjytimeve në rastet KO124/25 dhe KO119/14, se votimi i fshehtë për kryetarin e Kuvendit nuk është i ndaluar si mënyrë votimi dhe (2) të autorizojë kryesuesin e seancës konstituive që, me miratimin e deputetëve, të marrë vendimin për formimin e komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të pikës së tretë të rendit të ditës, "Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit".
72. Sipas deputetëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Kryesuesi i seancës konstituive, duke u mbështetur në Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO119/14 dhe KO124/25, të cilët theksojnë përgjegjësinë parësore të deputetëve për të gjetur mënyra për të konstituuar Kuvendin, si dhe duke parë që propozimi për Kryetar të Kuvendit nga partia më e madhe në Kuvend nuk mori votat e mjaftueshme, pas 6 (gjashtë) përpjekjeve me votim të hapur, ka iniciuar procedurën për votimin e fshehtë si përpjekje për të mbushur obligimin kushtetues për konstituimin e Kuvendit.

73. Tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! citojnë Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO119/2014, KO29/11 dhe KO124/25, lidhur me të cilat theksojnë se “Aktgjykimi KO119/2014 thotë që është obligim i të gjithë deputetëve që të jenë të pranishëm dhe të votojnë për ta konstituuar Kuvendin. Në rastin KO29/11 Gjykata vendosi që: Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit...Për më tepër, lidhur me obligimin e tyre si deputetë, neni 74 i Kushtetutës siguron që: deputetët e Kuvendit do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së Punës së Kuvendit. Për më tepër, Gjykata rikujton se votimi në Kuvend mund të bëhet në mënyra të ndryshme: duke votuar për, kundër, ose duke abstenuar, me votim të hapur ose me votim të fshehtë, apo në çfarëdo mënyre tjetër. Pra, Gjykata Kushtetuese kërkon të provohet çdo mundësi për të konstituuar Kuvendin, këtu përfshirë votimin e fshehtë. E njëjta përsëritet edhe në Aktgjykimin nr. KO124/25.”. Sipas deputetëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO124/25 “thekson se as Kushtetuta, e as Rregullorja e Kuvendit nuk flasin për mënyrën e votimit.”, por që parashtruesit e kërkesave këtë qëndrim e përdorin gabimisht si ndalim të votimit të fshehtë.
74. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesave lidhur me mungesën e bazës kushtetuese për votim të fshehtë dhe referimit të tyre në paragrafit 178 të Aktgjykimin të Gjykatës në rastin KO124/25, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se “Ajo që pohon paragrafi 178 i Aktgjykimin KO124/25 i lexuar edhe në dritë të Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese KO119/14, është që forma e votimit për kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit nuk është e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit, por format e votimit për të njëjtit janë përcaktuar dhe për më tepër janë paraqitur si të detyrueshëm për deputetët me qëllim të konstituimit të Kuvendit përmes Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese që kanë efekt normativ dhe direkt të zbatueshëm në rendin juridik të Republikës së Kosovës. Që të dy këto aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese transmetojnë mesazhin e njëjtë për deputetët, që të njëjtit pra duhet të: votojnë - pro, kundër ose abstenim, dhe që përmes votimit të hapur apo të fshehtë duhet të konstitudojnë Kuvendin.”
75. Në këtë drejtim, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! pretendojnë se (i) propozimi për votim të Komisionit për votim të fshehtë është veprim procedural në drejtim të konstituimit të Kuvendit përmes zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit; (ii) deputeti ka për detyrim që të qëndrojë në sallë, të votojë sipas ndërgjegjes së vet dhe vullnetit të lirë me pro, kundër apo abstenim Komisionin për votimin e fshehtë; dhe se (iii) refuzimi i deputetit për të qëndruar në sallë apo për të votuar bllokon konstituimin e Kuvendit.
76. Më tej, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! kundërshtojnë pretendimet e parashtruesve të kërkesave KO193/25 dhe KO196/25 lidhur me nenet 53, 57 dhe 122 të Rregullores së Kuvendit në raport me kreun IV (seanca konstituive), duke iu referuar institucioneve kushtetuese, zgjedhja e të cilave i nënshtrohet votimit të fshehtë. Në lidhje me këtë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se “Gjykata Kushtetuese ka thënë qartazi që seanca konstituive ka karakter të veçantë. Rrjedhimisht, mbi të zbatohen rregullat e parapara në Rregulloren e Punës së Kuvendit, përfshirë këtu “rregullat” e vendosura përmes Gjykatës Kushtetuese, apo thënë më qartë, përmes jurisprudencës së saj. Prandaj, ashtu siç pohon edhe Gjykata Kushtetuese në KO119/14, e përsëritur edhe në KO124/25, qëllimi i seancës konstituive është zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve, për t’i mundësuar Kuvendit ushtrimin e funksioneve të organit legjislativ. Për të bërë këtë, deputetët janë të detyruar të votojnë pro, kundër ose abstenim, dhe të zgjedhin kryetarin përmes metodës së hapur apo të fshehtë, dhe nuk mund të lirohen së vepruari kështu.”

77. Më tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! konsiderojnë se fakti që Rregullorja e Punës së Kuvendit është e heshtur te mënyra e votimit për Kryetar dhe Nënkryetarë të Kuvendit, nuk nënkupton që lejon vetëm një formë të votimit, *“sidomos kur merret parasysh që çdo devijim nga të provuarit e votimit të fshehtë për të konsituuar Kuvendin, do ishte qartazi në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencën e saj, dhe karakterit të obligueshëm e normativ të aktgjykimëve të kësaj Gjykate.”*
78. Për më tepër, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se Kryesuesi i seancës ka vepruar në përputhje me praktikat parlamentare dhe demokratike të hedhjes në votim të Komisionit për votim të fshehtë dhe se kalimi në votim të fshehtë nuk është shmangie nga rendi i ditës, nuk është shkelje arbitrare e praktikës së deritanishme, nuk është i palejuar dhe nuk e cenon synimin parësor për konstituim të Kuvendit. Sipas deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje!, ndryshimi i rrethanave implikon dhe ndryshim të mënyrave për të mbërritur të njëjtin qëllim. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO72/20, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se *“Gjykata ka konstatuar shprehimisht se, praktikat e mëparshme nuk mund të interpretohen në atë mënyrë që t’i ndalojnë deputetët për të vendosur ndryshe nga këto praktika, brenda kompetencave të tyre kushtetuese.”* Rrjedhimisht, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! pretendojnë se *“Edhe pse nuk është shfrytëzuar ndonjëherë deri më sot opsioni i votimit të fshehtë në konstituimin e Kuvendit, kjo në vetvete nuk e bën jokushtetues shfrytëzimin e këtij opsioni për herë të parë, sidomos duke marrë parasysh se vetë Gjykata e ka njohur si të pranueshëm një opsion të tillë, siç e kemi vërejtur më sipër. Njëjtë sikurse në rastin KO72/20, pra, votimi i fshehtë për kryetarin e Kuvendit, “përderisa është në vullnetin e Kuvendit dhe në vullnetin e shumicës së të zgjedhurve të popullit është kërkesë legjitime e bazuar në Kushtetutë”.*
79. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se mbetet për t’u parë nëse votimi i fshehtë për Kryetarin e Kuvendit është në vullnetin e shumicës së të zgjedhurve atëherë kur ekziston kuorumi i nevojshëm i deputetëve që votojnë “për”, “kundër” apo abstenojnë. Në këtë aspekt, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se kuorumi mungon në rastin konkret si rezultat i mos-pjesëmarrjes së një grupi të deputetëve në votimin për formimin e komisionit për votim të fshehtë, gjë për të cilën pretendojnë se bllokun shprehjen e vullnetit të shumicës dhe shpërfill *“haptas kërkesën e Gjykatës për “bashkëpunim në mirëbesim nga deputetët e zgjedhur për të gjetur kompromisin apo konsensusin e domosdoshëm për... mënyrën e votimit” (KO124/25, par. 185, theks i shtuar).”*
80. Përmes komenteve të dorëzuara në Gjykatë, ndër të tjera, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! pretendojnë se parashtruesit e kërkesave kanë praktikuar forma obstruktive që prekin frymën e në raste të veçanta edhe nenet e Kushtetutës. Në lidhje me këtë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! konsiderojnë se *“Të njëjtit ndonëse dihet qartë që propozimi për kryetarin e Kuvendit jipet nga partia e parë fituese kanë propozuar dhe vijojnë të propozojnë emra konkretë të tjerë për Kryetar (Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës). Disa deputetë të tjerë pjesë të Parashtruesve kanë vendosur kushte se kush a po si duhet të jetë propozimi i partisë së parë për Kryetar, nëpërmjet selektimit diskriminues negativ, duke përjashtuar nga mundësia për propozim të gjithë deputetët që ishin pjesë e Qeverisë në detyrë (Partia Demokratike e Kosovës). Ndërsa grupi Lidhja Demokratike e Kosovës në mënyrë jodiskriminuese ka përjashtuar mundësinë e votimit të çdo propozimi nga Lëvizja Vetëvendosje. Pra, përfaqësuesit e parashtruesve, në shkelje të drejtëpërdrejtë të Nenit 67, par. 2 të Kushtetutës, kanë ndërmarre veprime kundërkushtetuese, me qëllim të bllokimit të zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit.”*

81. Tutje, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se edhe pas publikimit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25, parashtruesit e kërkesave kanë vijuar të qëndrojnë në sallë pas ndërprerjes së seancës, marrin fjalën edhe pse në seancën konstituive nuk parashihet debat si dhe propozojnë për anëtarë të komisionit për votim të fshehtë deputetë nga radhët e subjektit Lëvizja Vetëvendosje!, duke i mohuar të drejtën e grupit më të madh parlamentar për propozimin e kandidatit për Kryetar të Kuvendit. Në anën tjetër, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! konsiderojnë se të gjitha veprimet nga Kryesuesi i seancës dhe ato të e Lëvizjes Vetëvendosje! *“janë në përputhje me frymën kushtetuese, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, parimet demokratike, qëllimin parësor të konsituimit ndaj dhe përkrahja e votimit të fshehtë shkon në këtë drejtim.”*.
82. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesave se kalimi nga votimi i hapur në votim të fshehtë paraqet ndryshim të rendit të ditës, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! pretendojnë se paragrafi 4 i nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit nuk e përcakton si pikë të rendit të ditës mënyrën e votimit për Kryetar të Kuvendit dhe nënkryetarë të Kuvendit. Më konkretisht, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se *“Referenca e pretenduesve tek nenet e Rregullores si neni 53 (Ndryshimi i rendit të ditës), neni 57 (Mocionet procedurale), si dhe në nenin 122 (Interpretimi i Rregullores së Kuvendit), është i pabazë, sepse nuk ka pasur dhe nuk ka propozim për ndryshim të rendit të ditës të Seancës Konstituive. Seanca ka mbetur në pikën e tretë të Rendit të ditës që është “Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit” dhe kjo pikë e e përfshin në vetvete votimin si veprim. Asnjë pikë e rendit të ditës nuk mund të jetë pikë e rendit të ditës nëse është e varur nga realizimi i një pike tjetër. Pika e rendit të ditës duhet të ketë objekt të vetpërmbushjes dhe elemente të qarta që i japin karakterin e pikës së veçantë të rendit të ditës. Prandaj, jo vetëm se proceduralisht propozimi për votim të Komisionit nuk paraqet as mocion procedural e as plotësim të rendit të ditës, e as interpretim të Rregullorës, rrjedhimisht “Votimi i Komisionit për Votim të Fshehtë” nuk i përmbushë elementet për të qenë pikë e veçantë e rendit të ditës. Për më tepër, në praktikën parlamentare të Kuvendit të Kosovës, sa herë që si pikë të rendit të ditës ka pasur zgjedhjen e një titullari institucional apo anëtarë të ndonjë organi tjetër kushtetues, për të cilët është paraparë zgjedhje me votim të fshehtë, asnjëherë nuk ka qenë pikë e rendit të ditës paraprake, votimi i Komisionit të Votimit të Fshehtë. Kjo, sepse, zgjedhja e titullarit apo anëtarit të organit kushtetues me votim të fshehtë e përfshinë, nënkupton edhe votimin e Komisionit të Votimit.”*.
83. Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se *“në asnjë nga seancat konstituive prej vitit 2001 nuk ka asnjë dokument që vërteton se ndonjëherë në rend të ditës është parashikuar forma e votimit e hapur apo e mbyllur dhe se ne skenar të seancës konstituive të ketë pasur ndonjë element që parashikon votimin paraprak për formën e votimit.”*. Në lidhje me këtë, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se votimi i fshehtë është e drejtë demokratike që nuk përbën ndryshim procedure, ndryshim rendi të ditës apo cenim të rrjedhës së seancës konstituive dhe se deputetët që janë kundër kësaj forme mjafton të shprehin vullnetin e tyre duke votuar kundër.
84. Gjithashtu, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se e kundërshtojnë pretendimin e parashtruesve të kërkesës KO193/25 lidhur me detyrimin e vetëm të grupit më të madh parlamentar për bashkëpunim me mirëbesim dhe qasje konstruktive, duke theksuar se Gjykata përmes paragrafit 130 të Aktgjykimit në rastin KO124/25, përveç obligimit për grupin më të madh parlamentar, *“vetëm dy fjali më poshtë, theksohet se: “Njëkohësisht, një detyrim i tillë vlen edhe për grupet tjera parlamentare, të cilët në frymën e bashkëpunimit dhe konsultimeve konstruktive propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët bazuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës, po ashtu*

zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve" (par. 130, theks i shtuar). Shih, po ashtu, fjalët identike në par. 190 ("një detyrim i tillë vlen edhe për grupet e tjera parlamentare")."

85. Në fund, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! theksojnë se obligimi i të gjithë deputetëve të Kuvendit për gjetjen e një mënyre për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit *"përsëritet të paktën gjashtë herë në aktgjykimet e 2014 dhe 2025: "është e drejtë dhe detyrë e të gjithë deputetëve të Kuvendit që të gjejnë mënyrën për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët të Kuvendit"* (par. 126, 141, 143, 186 dhe 190, duke iu referuar aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KO119/14, par. 127; theks i shtuar)". Në këtë drejtim, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje! shtojnë se për dallim nga parashtruesit e kërkesave, ata nuk tentojnë që t'i ikin detyrimit për bashkëpunim në mirëbesim, kompromis dhe konsensus dhe për konsultime konstruktive, por kërkojnë nga Gjykata që *"ta ritheksojë atë çka e ka përsëritur dy herë në aktgjykimin e fundit: "Një detyrim i tillë vlen edhe për grupet e tjera parlamentare"*.

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 1

[Përkufizimi i Shtetit]

- 1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.*
- 2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.*
- 3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.*

Neni 2

[Sovraniteti]

- 1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.*
- 2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.*
- 3. Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.*

Neni 4

[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

- 1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe*

garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.

6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Neni 7

[Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 63

[Parimet e Përgjithshme]

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Neni 64

[Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon: (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1)

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;*
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;*
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;*
- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;*
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;*
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;*
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;*
- (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;*
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;*
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;*
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;*
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

Neni 66

[Zgjedhja dhe Mandati]

- 1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.*
- 2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.*
- 3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.*
- 4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
- 5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.*

Neni 74

[Ushtrimi i Funksionit]

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.
2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.
3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.
4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.

Rregullore e Kuvendit të Republikës së Kosovës

KREU IV
KONSTITUIMI I KUVENDIT

Neni 7
Seanca konstituive

1. Seancën konstituive të Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.
2. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e thërret seancën konstituive, Kuvendi mbledhet vetë në ditën e 30 (tridhjetë).

Neni 8
Përgatitja e seancës konstituive

1. Përgatitjet për seancën konstituive të legjislaturës së Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit të legjislaturës së mëparshme.
2. Kryetari i legjislaturës së mëparshme, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit, e thërret mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike, që kanë fituar vende në Kuvend, për të përgatitur propozimin e rendit të ditës dhe për caktimin e vendeve të deputetëve në sallën e seancave plenare. Në rast se mbledhja nuk thirret brenda afatit pesë (5) ditorë, Kuvendi mbledhet vetë, në ditën e caktuar nga Presidenti.
3. Paragrafi 2 i këtij neni, nuk zbatohet në rast se Kuvendi mbledhet sipas nenit 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.
4. Rendi i ditës së mbledhjes konstituive të legjislaturës përmban:
 - 4.1. Formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve;
 - 4.2. Betimin e deputetëve;
 - 4.3. Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe
 - 4.4. Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit.
5. Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve votohet nga Kuvendi.
6. Përcaktimi i vendeve të deputetëve në sallë bëhet sipas fuqisë të subjekteve politike. Nëse dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, renditja e

tyre bëhet duke marrë për bazë numrin më të madh të votave që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvend.

Neni 9 **Kryesimi i seancës konstituive**

1. Punimet e seancës konstituive, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i drejton deputeti më i vjetër në moshë, i ndihmuar nga deputeti më i ri në moshë.
2. Nëse deputeti ose deputetët nga paragrafi 1 i këtij neni, mungojnë në seancën konstitutive ose refuzojnë drejtimin e seancës, angazhohen deputetët tjerë sipas kritereve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në seancën konstituive nuk zhvillohet debat.
4. Kryesuesi i seancës konstituive, pas hapjes së seancës dhe pas paraqitjes së rendit të ditës, kërkon nga subjektet politike të përfaqësuar në Kuvend, të caktojnë nga një deputet në Komisionin e Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve. Komisionin e kryeson deputeti i subjektit politik më të madh parlamentar.
5. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve e shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve, i paraqet Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit, verifikon praninë dhe kuorumin në seancën konstituive.

Neni 10 **Betimi i deputetëve**

1. Pas verifikimit të mandateve, kryesuesi i seancës konstitutive i fton deputetët të betohen solemnisht. Teksti i deklaratës së betimit është:

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë shtetasve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e sovranitetit, tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit. Betohem!”

2. Deklaratën e betimit e lexon kryesuesi i seancës. Deputetët betohen duke shqiptuar në fund të deklaratës, fjalën “Betohem!”. Secili deputet e nënshkruan deklaratën e betimit.

3. Deputeti që mungon në seancën konstituive të legjislaturës kur bëhet betimi dhe deputeti që fiton mandatin gjatë legjislaturës, betimin e bëjnë në seancën e parë të rregullt të radhës.

1. Deputeti i cili nuk e bën betimin në seancën e parë të rregullt të radhës, siç përcaktohet me paragrafin 3 të këtij neni, nëse ka pamundësi objektive për ta bërë atë brenda këtij afati, e dërgon njoftimin me shkrim te Kryetari i Kuvendit, lidhur me shkaqet që justifikojnë mungesën e tij dhe betimin e bën pas kalimit të rrethanave të tilla, por jo më vonë se në seancën e tretë të rregullt të radhës, pas fitimit të mandatit si në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 11 **Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit**

1. Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstituive, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga subjekti politik më i madh në Kuvend, të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit.
3. Kryesuesi i seancës konstituive konstaton rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, shpall zgjedhjen e Kryetarit dhe e fton të zërë vendin e tij.

Neni 12

Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit

1. Nënkyetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
2. Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet politike më të mëdha parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër, nga ai i Kryetarit.
3. Në rast se dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, e drejta e propozimit të nënkryetarit i takon subjektit që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet për Kuvend.
4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
5. Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.
6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:
 - 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe
 - 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.
7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit.

Neni 13

Mandati i Kuvendit

1. Mandati i Kuvendit, vazhdimi i tij dhe shpërndarja e Kuvendit, janë përcaktuar me nenet 66 dhe 82 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Pas shpërndarjes së Kuvendit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Presidenti e dorëzon dekreten e shpërndarjes në Kuvend.
3. Kuvendi e pezullon punën një ditë para fillimit të fushatës për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

86. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

87. Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesave i kanë ngritur kërkesat e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”

88. Përveç kritereve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42
(Saktësimi i kërkesës)

“1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”*

89. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

- (a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- (b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- (c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.*

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

90. Gjykata rikujton që lidhur me kërkesën KO124/25, parashtuesit e kërkesës kontestuan “Vendimin [e] Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajme për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar “transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025” për të cilin pretendonin se ishte në kundërshtim me nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 63 [Parimet e Përgjithshme], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], 70 [Mandati i Deputetëve], 72 [Papajtueshmëria], dhe 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës. Në kontekst të kësaj kërkesë, Gjykata vlerësoi që thelbi i pretendimeve të parashtuesve të kërkesës është çështja e konstituimit të Kuvendit pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve e filluar më 15 prill 2025, e cila nuk kishte përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës bazuar në juridiksionin e saj të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata vlerësoi se kërkesa është parashtuar nga palë të autorizuar dhe duke konsideruar se “seancat” e lartcekura kishin për qëllim konstituimin e Kuvendit, ku si pika të rendit të ditës në agjendë ishin (i) formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) dhënia e betimit të deputetëve; (iii) zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe (iv) zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit, vlerësoi dhe konstatoi se të njëjtat përbëjnë çështje kushtetuese të cilat duhet t’i nënshtrohen vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66, paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 67, neneve 70 dhe 74 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata konsideroi që kërkesa e parashtuesve të kërkesës është e pranueshme për shqyrtim. Në vijim të konstatimit të saj lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO124/25 vlerësoi që Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit të Kuvendit.
91. Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin KO124/25 konstatoi që: (i) “Seanca e konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar dhe si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës e njëjta nuk është zhvilluar në pajtim me përcaktimet dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe (ii) “Deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Aktgjykim duhet që sa më shpejt dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë të përfundojnë seancën konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.” Në pjesën operative të Aktgjykimit në rastin KO124/25, të 26 qershorit 2025 është specifikuar që i njëjti hyn në fuqi menjëherë.
92. Pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25 e deri në parashtrimin e kërkesave nga ana e parashtuesve të kërkesave, Seanca Konstituive e Kuvendit vazhdoi më 27 qershor 2025, 29 qershor 2025, 1 korrik 2025 dhe 3 korrik 2025. Në Seancën Konstituive, të 29 qershorit, 1 korrikut dhe 3 korrikut 2025, Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga partitë politike të propozojnë nga 1 (një) deputet për anëtar të Komisionit për Votim të Fshehtë. Në seancën e 29 qershorit 2025 të pranishëm ishin 95 (nëntëdhjetë e pesë) deputetë, megjithatë propozimi i Kryesuesit të Seancës Konstituive pas vendosjes në votim mori 53 (pesëdhjetë e tre) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në seancën e

- 1 korrikut 2025, të pranishëm ishin 100 (njëqind) deputetë, megjithatë propozimi i Kryesuesit pas vendosjes në votim mori 51 (pesëdhjetë e një) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në seancën e 3 korrikut 2025, të pranishëm ishin 99 (nëntëdhjetë e nëntë) deputetë, megjithatë propozimi i Kryesuesit pas vendosjes në votim mori 54 (pesëdhjetë e katër) vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.
93. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesave pretendojnë që propozimi i Kryesuesit të Seancës Konstituive për propozimin e anëtarëve për Komisionin për Votim të Fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, gjatë seancave të 29 qershorit, 1 dhe 3 korrikut 2025 nuk është në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25. Në vijim, parashtruesit e kërkesave pretendojnë që *“Vendimi i Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”* është nxjerrë në kundërshtim me nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], 74 [Ushtrimi i Funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
 94. Megjithatë, ashtu siç është elaboruar edhe te pjesa e fakteve, nga data e parashtrimin të kërkesave, të 3 dhe 4 korrikut 2025, respektivisht deri më 26 korrik 2025, në të cilën datë ka përfunduar edhe afati 30 (tridhjetë) ditë i përcaktuar me pikën II, paragrafi 2 të Aktgjykimit në rastin KO124/25, më 5 korrik, 7 korrik, 9 korrik, 11 korrik, 13 korrik, 15 korrik, 17 korrik, 19 korrik, 21 korrik dhe 23 korrik 2025 janë mbajtur seancat për konstituimin e Kuvendit, ku Kryesuesi me qëllim të themelimit të Komisionit për Votim të Fshehtë sërisht kishte ftuar përfaqësuesit e subjekteve politike për propozimin e një deputeti për anëtar të Komisionit për Votim të Fshehtë. Më 24 korrik 2025, Gjykata me qëllim të parandalimit të dëmeve të pariparueshme dhe për arsye të interesit publik nxori Vendimin *ex officio* për masën e përkohshme, përmes të cilës vendosi që të ndalojë çdo vendim dhe veprim të deputetëve të zgjedhur pas datës 26 korrik 2025.
 95. Në kuadër të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesave, Gjykata vëren që kërkesa KO193/25 është parashtruar nga 13 (trembëdhjetë) deputetë, përderisa kërkesa KO196/25 është parashtruar nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë, që është më shumë se minimumi i kërkuar me nenin 113, paragrafin 5 të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht konsideron se është plotësuar kriteri për palën e autorizuar.
 96. Në vijim dhe në kontekst të pretendimeve të lartcekura, dhe që ndërlidhen me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124, Gjykata duke marrë për bazë procedurën e zhvilluar gjatë seancave për konstituimin e Kuvendit të mbajtura pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25 deri në përfundimin e afatit 30 (tridhjetë) ditë të përcaktuar me pikën II, paragrafit 2 të po të njëjtit Aktgjykim, konstaton që si për nga aspekti i konstatimeve të saja lidhur me vlerësimin e afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit, procedurën e Zgjedhjes së Kryetarit/ës dhe nënkryetarëve, përfshirë këtu detyrimin e përcaktuar në pikën II të dispozitivit të tij, e që ka rezultuar në mospërfundimin e Seancës Konstituive të Kuvendit, Aktgjykimi i Gjykatës nuk është zbatuar.
 97. Rrjedhimisht, Gjykata marrë për bazë elaborimin si më sipër, dhe rrethanat që edhe pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditë, të përcaktuar me pikën II, paragrafin 2 të dispozitivit të Aktgjykimit në rastin KO124/25, si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, Seanca Konstituive nuk është realizuar më të gjitha elementet thelbësore për konstituimin e Kuvendit, Gjykata konstaton që kërkesat e parashtruesve të kërkesave janë të pranueshme dhe rrjedhimisht do të vazhdojë me shqyrtimin e meritave të kërkesave.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

98. Gjykata, fillimisht rithekson që në rastin KO124/25 për objekt shqyrtimi të kërkesës së parashtruesve kishte vlerësimin (i) e çështjes ndërlidhur me konstituimin e Kuvendit dhe afatit për konstituimin e tij, si dhe (ii) të pretendimit të parashtruesve të kërkesës për “ndryshimin e rendit të ditës së Seancës Konstituive” dhe propozimin e Kryesuesit për themelimin e “Komisionit për Votim të Fshehtë”.
99. Gjykata, në mënyrë të përmbledhur rikujton që përmes Aktgjykimit të saj në rastin KO124/25, të 26 qershorit 2025 lidhur me afatin për konstituimin e Kuvendit konstatoi që *“Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës. Çdo interpretim ndryshe do të relativizonte rendin kushtetues, respektivisht Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional, në kundërshtim me natyrën funksionale të një demokracie të udhëhequr nga parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit.”* (shih, paragrafin 145 të Aktgjykimit). Këtë konstatim, Gjykata e mbështeti ndër tjerash në atë që përcaktimet në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës nënkuptojnë se mbajtja e seancës konstituive brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor, nuk është mundësi formale apo orientuese, por detyrim kushtetues që lidhet ngushtë me fillimin e mandatit të legjislaturës së re. Sipas Gjykatës, kërkesa nga paragrafi 1 i nenit 66 të Kushtetutës, që Kuvendi të mbajë Seancën Konstituive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nuk do të thotë vetëm që deputetët e zgjedhur duhet të mblidhen fizikisht në sallë po që kuptimi i kësaj norme duhet të jetë substancial dhe funksional, duke nënkuptuar që brenda këtij afati duhet të realizohen të gjitha veprimet kushtetuese që rezultojnë në konstituimin e Kuvendit, të cilat përfshijnë (i) verifikimin e mandateve të deputetëve të zgjedhur, (ii) dhënien e betimit nga ana e tyre dhe (iii) zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata ka ritheksuar që pa përfundimin me sukses të këtyre veprimeve kushtetuese, Kuvendi nuk mund të konsiderohet juridikisht i konstituuar dhe, rrjedhimisht, nuk mund të ushtrojë asnjë nga funksionet që Kushtetuta i ka caktuar (shih, paragrafët 131-132 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).
100. Përderisa në kuptimin të vlerësimit të çështjes ndërlidhur me pretendimet për “ndryshimin e rendit të ditës” së seancës konstituive dhe propozimin e Kryesuesit të Seancës Konstituive për themelimin e “Komisionit për Votim të Fshehtë”, Gjykata konkludoi që *“marrë për bazë vlerësimin dhe konstatimet si më sipër konsideron që zhvillimi dhe përfundimi i Seancës Konstituive duhet të udhëhiqet në pajtim me përcaktimet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.”* (shih, paragrafin 187 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).
101. Në vijim të këtyre konstatimeve, Gjykata përmes pikës II të Aktgjykimit në rastin KO124/25 vendosi që deputetët e zgjedhur të Kuvendit, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66, në ndërlidhje me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 67, si dhe nenet 70 dhe 74 të Kushtetutës, në pajtim me Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit, si dhe në përputhje me konstatimet e dhëna në këtë

Aktgjykim, janë të obliguar që, dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, të përmbushin detyrimin kushtetues për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes zgjedhjes së Kryetarit/es dhe të nënkryetarëve të tij.

102. Gjykata rikujton që parashtuesit e kërkesave në thelb pretendojnë që (i) propozimi i Kryesuesit të Seancës Konstituive për propozimin e anëtarëve për Komisionin për Votim të Fshehtë për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, gjatë seancave të 29 qershorit, 1 dhe 3 korrikut 2025 nuk është në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25; dhe (ii) në vijim të kësaj specifikojnë që *“Vendimi i Kuvendit për votimin e Komisionit për votim të fshehtë, në kuadër të vazhdimit të seancës konstituive të Legjislaturës IX të Kuvendit, të mbajtur sipas transkriptit të datës 29 qershor 2025.”* është nxjerrë në kundërshtim me nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit], 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], 74 [Ushtimi i Funksionit] dhe 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës.
103. Pretendimet e parashtuesve të kërkesave kundërargumentohen nga deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje!, Znj. Saranda Bogujevci, e cila në komentet e dorëzuara në Gjykatë, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje!, në thelb, thekson që (i) votimi i fshehtë është i lejueshëm si një kompromis i mundshëm mes deputetëve, me qëllim të konstituimit të Kuvendit; dhe (ii) propozimi i Kryesuesit të Seancës për formimin e komisionit për votim të fshehtë paraqet përpjekje të sinqertë për të gjetur "kompromisin apo konsensusin" e nevojshëm për mënyrën e votimit, me qëllim të konstituimit të Kuvendit; (iii) mos-pjesëmarrja e deputetëve në votimin për formimin e komisionit për votim të fshehtë bllokoi shprehjen e vullnetit të shumicës; dhe (iv) të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit kanë për obligim gjetjen e një mënyre për të zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit.

I. Lidhur me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës nga deputetët e zgjedhur të Kuvendit dhe veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive

104. Ashtu siç është elaboruar si më sipër, në kontekst të zbatimit të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata konstaton që si rezultat i përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditorë të përcaktuar me pikën II.2 të dispozitivit të Aktgjykimit në rastin KO124/25 brenda të cilit Seanca Konstituive e Kuvendit nuk ka përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit, deputetët e zgjedhur nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës.
105. Në vijim të konstatimit të lartcekur, që deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës brenda afatit të përcaktuar 30 (tridhjetë) ditor të përcaktuar në pikën II paragrafin 2 të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25, Gjykata në rrethanat e përfundimit të këtij afati brenda të cilit Kuvendi nuk ka arritur që të konstituohet dhe vendosjes *ex officio* të masës së përkohshme, të 24 korrikut 2025 për ndalim të çdo vendimi dhe veprimi të deputetëve të zgjedhur të Kuvendit deri në zgjidhjen e meritave të kërkesave, konsideron që objekt i vlerësimit dhe interpretimit lidhur me kërkesat para saj janë (i) vlerësimi i veprimeve të Kryesuesit të Seancës Konstituive gjatë kryesimit të seancave për konstituimin e Kuvendit, të mbajtura brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25; dhe (ii) përcaktimi i detyrimeve të deputetëve të zgjedhur për konstituimin e Kuvendit dhe mënyrën e zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25.
106. Gjykata, fillimisht vë në dukje që bazuar në paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Në ndërlidhje me këtë dispozitë

kushtetuese, rregulli 60 (Zbatimi i vendimeve) i Rregullores së Punës të Gjykatës gjithashtu përcakton që: (i) të gjitha organet kushtetuese, përfshirë gjykatat e autoritetet tjera, janë të obliguara të respektojnë dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.

107. Gjykata po ashtu ka theksuar që përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar. Sipas Gjykatës çdo pengesë ose mungesë bashkëpunimi në përmbushjen e detyrimeve dhe autorizimeve kushtetuese, është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës KO72/20, parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, i 30 prillit 2020, paragrafët 476-478).
108. Gjykata, vë në dukje që Komisioni i Venecias thekson që zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është një kërkesë thelbësore e sundimit të ligjit (shih, Opinionin CDL-AD(2018)028 e Komisionit të Venecias lidhur me Rregullimet kushtetuese dhe ndarja e pushteteve, si dhe pavarësia e gjyqësorit dhe e organeve të zbatimit të ligjit, miratuar më 14-15 dhjetor 2025, paragrafi 77). Gjykata, në vijim, vë në dukje se çështja e detyrimit për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatave të Kushtetuese është trajtuar edhe nga Komisioni i Venecias, dhe në lidhje me këtë, ky i fundit, në një ndër opinionet e saj, përkatësisht përmes Opinionit CDL-AD (2017) 003 përkitazi me Ligjin për ndryshimin e Ligjit Organik Nr. 2/1979 mbi Gjykatën Kushtetuese të Spanjës (i miratuar më 10-11 mars 2017) trajton çështjen e natyrës së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe kujt i takon obligimi për t'i ekzekutuar, nëse këto të fundit nuk respektohen nga palët të cilave i janë drejtuar. Përmes këtij opinionit, Komisioni i Venecias theksoi se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe kanë karakter detyrues (paragrafët 8 dhe 69 të Opinionit). Sipas Komisionit të Venecias: *“Kjo është pasojë e supremacisë së Kushtetutës. Mosrespektimi i një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese është mosrespektim i Kushtetutës dhe i pushtetit kushtetues, e cila i atribuon Gjykatës Kushtetuese kompetencën për të garantuar këtë supremaci të Kushtetutës. Kur një zyrtar publik refuzon të zbatojë një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, ai ose ajo shkel Kushtetutën, duke përfshirë parimet e sundimit të ligjit, ndarjen e pushteteve dhe bashkëpunimin lojal të organeve shtetërore [...]”* (shih, paragrafin 8 të Opinionit).
109. Prandaj, në kontekst të çështjeve të ngritura nga parashtruesit e kërkesës në rastin KO124/25, Gjykata konsideron se sikurse (i) lidhur me konstituimin e Kuvendit dhe afatin për konstituimin e tij, ashtu dhe lidhur me (ii) pretendimin për *“ndryshimin e rendit të ditës”* së Seancës Konstituive dhe propozimin e Kryesuesit për themelimin e *“Komisionit për Votim të Fshehtë”*, ka dhënë interpretimin, vlerësimin dhe konstatimet e saj, përfshirë edhe përcaktimin e detyrimit që deputetët e zgjedhur në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtimi i Funksionit] të Kushtetutës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me Aktgjykimin në rastin KO124/25 duhet që sa më shpejt dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë të përfundojnë Seancën Konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij.

110. Gjykata, rikujton praktikën e saj gjyqësore përmes të cilës është theksuar që “*deputetët janë të obliguar të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës*” (shih, rastin KO98/11, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 20 shtatorit 2011, paragrafët 58 dhe 59) dhe “[...] *Përderisa respektohet Kushtetuta, çdo zgjidhje e të zgjedhurve dhe njëkohësisht përfaqësuesve të popullit, duhet respektuar [...]*” (shih rastin KO72/20, paragrafi 357). Në këtë kuptim, neni 74 [Ushtrimi i Funksionit] i Kushtetutës, përcakton detyrim për secilin deputet që të ushtrojë funksionin e tij/saj në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës. Thënë këtë, çdo veprim apo mosveprim i deputetëve duhet të vlerësohet në dritën e këtij standardi kushtetues.
111. Megjithatë, përkundër këtij standardi kushtetues, Gjykata konstaton që deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e 26 qershorit 2025, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO124/25.
112. Ndërsa lidhur me veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive, Gjykata, rikujton paragrafin 2 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit përmes të cilit përcaktohet që Kryetari i legjislaturës paraprake, në mbledhjen me kryetarët e subjekteve politike që kanë fituar vende në Kuvend, merret me propozimin e rendit të ditës dhe çështje të tjera organizative për Seancën Konstituive, ndërsa është pikërisht paragrafi 4 i nenit 8 të Rregullores që përcakton në mënyrë taksative dhe formale rendin e ditës për Seancën Konstituive.
113. Gjykata, rikujton që neni 76 [Rregullorja e Punës] i Kushtetutës e përcakton Rregulloren e Kuvendit të miratuar nga 2/3 e votave të deputetëve si një akt me fuqi ligjore detyruese, përmes të cilës rregullohet organizimi dhe funksionimi i Kuvendit. Kjo dispozitë kushtetuese obligon Kuvendin të veprojë brenda procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi, në përputhje me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës
114. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit i cili përcakton që: “*Rendi i ditës së mbledhjes konstituive të legjislaturës përmban: 4.1 Formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve; 4.2 Betimin e deputetëve; 4.3 Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe 4.4 Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit*” (shih, paragrafin 153 të Aktgjykimit KO124/25). Ky rend i ditës përfaqëson përmbajtjen e vetme të Seancës Konstituive dhe duhet të respektohet me përpikëri nga Kryesuesi i Seancës Konstituive, pa devijime dhe pa hapësirë për ndërhyrje procedurale që bien ndesh me rregullimin kushtetues të konstituimit të Kuvendit.
115. Në vijim, Gjykata po ashtu vëren se paragrafi 3 i nenit 9 të Rregullores së Kuvendit ndalon shprehimisht zhvillimin e debatit gjatë Seancës Konstituive, duke reflektuar karakterin solemn, të mbyllur dhe të paracaktuar të kësaj seance. Kjo ndalesë për debat, në ndërlidhje me rendin e ditës të përcaktuar në mënyrë taksative në paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, e përjashton çdo veprim që nuk është parashikuar formalisht dhe qartësisht në kornizën normative, respektivisht Kreun IV të Rregullores së Kuvendit që rregullon konstituimin e Kuvendit.
116. Gjykata, rikujton që në kontekst të vlerësimit të pretendimit të parashtruesve të kërkesës në rastin KO124/25 për “*ndryshimin e rendit të ditës*” së Seancës Konstituive ndërlidhur me propozimin e Kryesuesit për themelimin e “*Komisionit për Votim të Fshehtë*” gjatë seancave të zhvilluara më 1, 3, dhe 5 maj 2025, Gjykata ka konstatuar që zhvillimi dhe përfundimi i Seancës Konstituive duhet të udhëhiqet në pajtim me përcaktimet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit

dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (shih, paragrafin 187 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).

117. Thënë këtë, Gjykata tashmë ka konstatuar që rendi i ditës i Seancës Konstituive sipas paragrafit 4 të nenit 8 të Kreut IV të Rregullores së Kuvendit është akt formal, përmes të cilit në mënyrë taksative janë përcaktuar pikat e rendit të ditës, për konstituimin e Kuvendit. Si i tillë, rendi i ditës i Seancës Konstituive, në frymën e neneve 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës përfaqëson një detyrim kushtetues për deputetët e zgjedhur të Kuvendit në përfundimin e Seancës Konstituive me realizmin e të gjitha pikave të rendit të ditës për konstituimin e Kuvendit brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë. Ashtu siç është theksuar në Aktgjykimin e saj në rastin KO124/25, Gjykata sërish nënvizon që Kreu IV (Konstituimi i Kuvendit) i Rregullores së Kuvendit nuk përmban asnjë referencë në nenet 53 (Ndryshimi i rendit të ditës) dhe 57 (Mocionet procedurale), si dhe as në nenin 122 (Interpretimi i Rregullores së Kuvendit) (shih, paragrafin 176 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).
118. Në vijim të kësaj, Gjykata vlerëson që posaçërisht pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25, Kryesuesi i Seancës Konstituive, në përmbushjen e detyrës si drejtues i punimeve të Seancës Konstituive dhe në frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit me të gjithë deputetët e zgjedhur ka pasur për detyrim zbatimin e konstatimeve të Gjykatës në rastin KO124/25, të cilat në mënyrë të qartë dhe të saktë përcaktonin detyrimet e tij dhe të të gjithë deputetëve për përfundimin e Seancës Konstituive përmes zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit, në pajtim me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 67, ndërlidhur me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67, nenit 74 të Kushtetutës, Kreut IV të Rregullores së Kuvendit si dhe në pajtim me praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.
119. Në rrethana të tilla, Gjykata konsideron që në kuptim të përgjegjësisë së Kryesuesit për kryesimin e Seancës Konstituive, i njëjti ka pasur për detyrë të udhëheq punimet e Seancës Konstituive sipas rendit formal të ditës deri në përmbylljen e procesit për konstituim të Kuvendit. Thënë këtë, Gjykata vë në dukje që funksioni i Kryesuesit të Seancës Konstituive është i përcaktuar qartë në paragrafin 1 të nenit 9 (Kryesimi i seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit përcaktohet se *“Punimet e seancës konstituive, deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i drejton deputeti më i vjetër në moshë, i ndihmuar nga deputeti më i ri.”*
120. Prandaj, çdo veprim apo vendim i një Kryesuesi/eje të Seancës Konstituive në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj gjatë kryesimit të seancës të përcaktuar shprehimisht në Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe të specifikuar më tej përmes Aktgjykimit KO124/25 të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje të paragrafit 1 të nenit 116 të Kushtetutës.
121. Ashtu siç është elaboruar më sipër, pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25 dhe deri në parashtrimin e kërkesave aktuale nga parashtruesit e kërkesave, Seanca Konstituive ka vazhduar më 27 dhe 29 qershor dhe më 1 dhe 3 korrik 2025. Në të gjitha këto seanca, Kryesuesi i Seancës ka përsëritur në vazhdimësi kërkesën drejtuar grupeve parlamentare për të propozuar nga 1 (një) anëtar për Komisionin për Votim të Fshtëhtë. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se në asnjërën nga këto seanca nuk është arritur themelimi i këtij Komisioni.

122. Gjykata rikujton që në Aktgjykimin KO124/25 ka konstatuar se Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk e përcakton mënyrën e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit. Megjithatë në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar se “[...] *kërkohej bashkëpunim në mirëbesim nga deputetët e zgjedhur për të gjetur kompromisin apo konsensusin e domosdoshëm për të gjitha çështjet që dalin apo mund të dalin duke përfshirë zgjedhjen e kandidatit/ es për Kryetar/e të Kuvendit, apo mënyrën e votimit, gjatë formimit të organeve kushtetuese pas zgjedhjeve të lira, por gjithmonë brenda kërkesave dhe kufijve të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e Kuvendit (shih paragrafin 185 të Aktgjykimit KO124/25)*”.
123. Në këtë kuptim, mungesa e konsensusit të deputetëve për të vazhduar me ndryshimin e votimit, respektivisht kalimin në votim të fshehtë për votimin e kandidatit të njëjtë për Kryetarin e Kuvendit, e veçanërisht mos propozimi apo mos delegimi i anëtarëve në përbërje të Komisionit për Votim të Fshehtë është tregues i qartë se procesi për konstituimin e Kuvendit nuk mund të mbetet i varur nga mbledhja fizike e deputetëve për çdo 48 (dyzet e tetë) orë, ku në vazhdimësi propozohet formimi i Komisionit për Votim të Fshehtë.
124. Gjykata thekson që e drejta e deputetit më të vjetër në moshë për të drejtuar punimet e Seancës Konstitutive deri në zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, ashtu siç parashihet në nenin 9 (Kryesimi i Seancës Konstitutive) të Rregullores së Kuvendit, duhet të interpretohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit kushtetues të konstituimit të Kuvendit.
125. Tutje, Gjatë zhvillimit të seancave për konstituimin e Kuvendit më 1, 3, dhe 5 maj 2025, dhe posaçërisht atyre të vazhduara pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25, sipas shkresave të lëndës, Gjykata vëren që deputetët nuk janë dakorduar për të deleguar anëtarë në përbërjen për themelimin e Komisionit për Votim të Fshehtë. Rrjedhimisht, në mungesë të vullnetit të deputetëve për themelimin e Komisionit për Votim të Fshehtë, propozimi i përsëritur nga Kryesuesi i Seancës Konstituive ndaj grupeve parlamentare për delegim të deputetëve në Komision, ka rezultuar në pamundësinë që brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë, t’iu mundësohet deputetëve të zgjedhur të Kuvendit që të votojnë për Kryetar të Kuvendit.
126. Në vijim të elaborimit, Gjykata vëren se në seancat e mbajtura për konstituimin e Kuvendit brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit në rastin KO124/25, përkatësisht nga 27 qershori deri më 26 korrik 2025 nuk është arritur që të votohet kandidati/tja për Kryetar të Kuvendit. Për pasojë, Gjykata vlerëson që veprimet e përsëritura të Kryesuesit për të zhvilluar dhe bashkërenduar mbajtjen e Seancës Konstituive në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, përbëjnë tejkalim të kompetencave formale dhe solemne të ndërlidhura me rendin e ditës së Seancës Konstituive, e cila njëherësh ka pasur për pasojë moskonstituimin e Kuvendit sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 66, në ndërlidhje me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës.
127. Gjykata thekson se cilitdo apo cilësdo që i takon nderi për të kryesuar Seancën Konstituive, njëkohësisht i takon edhe detyrimi që në përputhje me Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe nenin 76 [Rregullorja e Kuvendit] të Kushtetutës të udhëheqë Seancën për konstituimin e Kuvendit në frymën e mirëbesimit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit konstruktiv me të gjithë deputetët e zgjedhur drejt përfundimit të saj me sukses sipas

përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 66, dhe paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve] të Kushtetutës.

128. Përfundimisht, Gjykata konstaton që (i) deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25 pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor; (ii) veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive nuk janë në pajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 116 të Kushtetutës; dhe (iii) të gjitha seancat e mbajtura nga data 27 qershor deri më 26 korrik 2025 duhet të shpallen të pavlefshme.
129. Bazuar në konstatimet e saj, Gjykata, në kuptim të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO124/25 pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor se (i) deputetët e zgjedhur të Kuvendit nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25 dhe (ii) veprimet e Kryesuesit të Seancës Konstituive të Kuvendit nuk janë në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë është shkelur paragrafi 1 i nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat konstatime rezultojnë në shpalljen e pavlefshme të të gjitha seancave të mbajtura nga data 27 qershor deri më 26 korrik 2025. Rrjedhimisht Gjykata vlerëson që Kryesuesi i Seancës duhet të vazhdojë me pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, që përmban zgjedhjen e Kryetarit/es dhe Nënkryetarëve të Kuvendit, si dhe në mungesë të konsensusit për votim të mbyllur, procedura duhet të vazhdojë me votim të hapur.

II. Lidhur me detyrimin për vazhdimin dhe përfundimin e Seancës Konstituive

130. Ashtu siç është theksuar edhe përmes praktikës së saj gjyqësore, në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata në vazhdimësi ka ritheksuar që në shërbim të ruajtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burim i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti.
131. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, rithekson rëndësinë e interpretimit të Kushtetutës lidhur me konstituimin e Kuvendit. Për më tepër, Gjykata sërish thekson që mosrespektimi i Aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese nga ana e deputetëve të zgjedhur është mosrespektim i Kushtetutës dhe i mandatit të tyre kushtetues, dhe mosrespektimi i saj në rrethanat e moskonstituimit të Kuvendit bie ndesh me parimet e mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës..
132. Në vijim të kësaj, Gjykata sërish vë në dukje parimet dhe standardet që ndërlidhen me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ashtu siç është specifikuar më lart, Gjykata rithekson që mosrespektimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën mosrespektim të Kushtetutës. Prandaj, në kuptim të moszbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ashtu siç është afirmuar edhe nga Komisioni i Venecias, masat e nxjerra për të zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë legjitime, (shih paragrafin 69 të Opinionit CDL-AD (2017) 003). Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson që, për faktin që seancat e deritanishme nuk janë zhvilluar sipas Aktgjykimit në rastin KO124/25, procesi duhet të kthehet në fazën që kishte mbetur. Për këtë arsye, Gjykata thekson që vazhdimi i Seancës Konstituive me qëllimin për të konstituuar dhe funksionalizuar Kuvendin e Republikës së Kosovës është në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe që vazhdimi i Seancës Konstituive konsiderohet si i domosdoshëm në mënyrë që Kuvendi i Republikës së Kosovës

si organ përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës të jetë plotësisht funksional në ushtrimin e mandatit kushtetues.

133. Në dritën e konstatimit të Gjykatës për moszbatim të Aktgjykimit të saj në rastin KO124/25, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ka rezultuar në mospërbushjen e detyrimeve kushtetuese nga ana e deputetëve të zgjedhur për konstituimin e Kuvendit, Gjykata në vijim rithekson detyrimin kushtetues të deputetëve të zgjedhur për konstituimin e Kuvendit. Domosdoshmëria për përmbushjen e pikave të rendit të ditës për konstituimin e Kuvendit buron në mënyrë të drejtpërdrejtë nga efektet dhe pasojat që konstituimi i organit përfaqësues kushtetues prodhon në funksionimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këto rrethana, dhe marrë për bazë kërkesat e parashtruara para saj, Gjykata në cilësinë e autoritetit përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, rithekson funksionin jetik të një Kuvendit të konstituuar pas zgjedhjeve, ku legjitimohen përfaqësuesit e zgjedhur të popullit për një mandat kushtetues përfaqësimi 4 (katër) vjeçar në Kuvendin e Republikës, dhe më pas, Qeverinë e tyre, të zgjedhur përmes Kuvendit, sipas procedurave të përcaktuara në Kushtetutë.
134. Thënë këtë, Gjykata, konsideron që vazhdimi i Seancës Konstituive për ti dhënë efekt përmbushjes së detyrimit kushtetues për konstituimin e Kuvendit është i domosdoshëm në mënyrë që të jetësohet themelimi dhe funksionimi efektiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe që si i tillë i shërben zbatimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës.
135. Gjykata ka theksuar që një Seancë Konstituive që mbahet, por nuk e zgjedh Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit është seancë e papërfunduar, meqenëse nuk përmbush kërkesën e paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës. Në vijim të kësaj dhe në kuptim të përfundimit të Seancës Konstituive, Gjykata rithekson rëndësinë e vazhdimit të kësaj seance dhe përfundimit të saj me konstituimin e Kuvendit në përputhje me parimet dhe vlerat kushtetuese e cila buron nga parimet dhe përcaktimet kushtetuese dhe e cila duhet të ndjekë frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit konstruktiv të të gjithë deputetëve të zgjedhur.
136. Sipas interpretimit kushtetues, paragrafi 2 i nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] i Kushtetutës përmban dy (2) elemente të pandashme, përkatësisht (i) të drejtën e grupit më të madh parlamentar për të propozuar Kryetarin/en e Kuvendit (shih, interpretimin e Gjykatës në rastin KO119/14, paragrafi 116); dhe që (ii) kandidati/ja i/e propozuar zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Thënë këtë dhe sa i përket elementit të dytë, Gjykata vlerëson se kërkesa që Kryetari i Kuvendit të zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përcakton një standard të qartë dhe objektiv të legjitimitetit kushtetues.
137. Në vijim, Gjykata po ashtu ka theksuar që shumica e kërkuar për zgjedhjen e Kryetarit/es së Kuvendit është *“me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”* përkatësisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota në një Kuvend prej 120 (njëqind e njëzet) deputetësh dhe se sipas Gjykatës shmangia nga ky standard kushtetues, në çfarëdo rrethane, cenon legjitimitetin kushtetues të procesit të konstituimit të Kuvendit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
138. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar që mos arritja e shumicës së kërkuar për zgjedhjen e kandidatit të propozuar nga grupi më i madh parlamentar për Kryetar të Kuvendit, përbën

në anën tjetër, dështim të deputetëve për të përmbyllur me sukses Seancën Konstituive, edhe në kuptim të detyrimit kushtetues të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës (shih, paragrafin 129 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).

139. Gjykata rikujton që përmes Aktgjykimit të saj në rastin KO124/25 ka përcaktuar që *“zhvillimi dhe përfundimi i Seancës Konstituive duhet të udhëhiqet në pajtim me përcaktimet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.”* (shih, paragrafin 187 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).
140. Për këtë qëllim Gjykata konsideron që Kryesuesi i Seancës Konstituive duhet të vazhdojë seancën me pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës, duke ftuar përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit dhe të vijoje me procedurën e votimit të kandidatit ashtu siç është filluar dhe realizuar gjatë 5 (pesë) seancave të saj të para për votimin e kandidatit/es për Kryetar/e të Kuvendit. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton që në seancat për konstituimin e Kuvendit të mbajtura më 19 prill, 23 prill, 25 prill, 27 prill dhe 29 prill pas propozimit të kandidatit nga ana e grupit më të madh parlamentar procedura e votimit është zhvilluar përmes votimit të hapur (shih, Vendimet [Nr. 09-V-004; të 19 prillit 2025; Nr. 09-V-005; të 23 prillit 2025; Nr. 09-V-006; të 25 prillit 2025; Nr. 09-V-007; të 27 prillit 2025; dhe Nr. 09-V-008, të 29 prillit 2025]).
141. Në kuptim të praktikave të mëparshme parlamentare, Gjykata bazuar në dokumentacionin e pranuar nga Kuvendi, përkatësisht transkriptet e seancave konstituive të Kuvendit të Legjislaturave III (Seanca konstituive e 4 dhe 9 janarit 2008), IV (Seanca konstituive e 21 shkurtit 2011); V (Seanca konstituive e 17 korrikut, 18 shtatorit dhe 8 dhjetorit 2014); VI (Seanca konstituive e 3, 4, 10, 14, 24 gushtit dhe e 7 shtatorit 2017); VII dhe VIII vëren se në këto seanca për konstituimin e Kuvendit, Kryetari dhe nënkryetarët e tij janë zgjedhur përmes votimit të hapur. Përkatësisht, sipas transkriptit të seancës konstituive, të 4 dhe 9 janarit 2008, bazuar në Kornizën Kushtetuese të Kosovës, më 9 janar 2008, pas propozimit të kandidatëve për Kryetarë dhe nënkryetarë nga shumica shqiptare, kryesuesi i seancës konstituive pas konstatimit se të pranishëm në këtë seancë ishin 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë, ftoi *“deputetët që me një votim formal me ngritje të dorës, pa debat, të deklarojnë për zgjedhjen e tyre”*. Si rezultat i votimit, Kryetari dhe 5 (pesë) nënkryetarët u zgjodhën me 88 (tetëdhjetë e tetë) vota “për”, përderisa 1 (një) votoi kundër dhe asnjë abstenu. Në vijim, bazuar në transkriptin e seancës konstituive të 21 shkurtit 2011 rezulton që lidhur me pikën e rendit të ditës për zgjedhjen e Kryetarit, pas propozimit të kandidatit për kryetarë nga grupi parlamentar Partia Demokratike e Kosovës, Kryesuesja e seancës konstituive pasi konstatoi që të pranishëm ishin 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) deputetë ftoi të njëjtin që *“me ngritje dore të deklarojnë “për”, “kundër” ose “abstenim”, ku për zgjedhjen e Kryetarit 90 (nëntëdhjetë) deputetë kishin votuar për, 17 (shtatëmbëdhjetë) kishin votuar kundër dhe 3 (tre) deputetë kishin abstenuar. Në po të njëjtën seancë, lidhur me pikën e katërt të rendit të ditës për zgjedhjen e nënkryetarëve, zgjedhja e tyre ishte realizuar përmes votimit të hapur, në të cilin rast ishin zgjedhur pesë nënkryetarët e Kuvendit. Së treti, bazuar në transkriptin e “mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 17 korrik, 18 shtator dhe 8 dhjetor 2014”* rezulton që në seancën e 8 dhjetorit 2014, lidhur me pikën e rendit të ditës për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit, pas propozimit të kandidatit për Kryetar të Kuvendit, pasi konstatoi që të pranishëm ishin 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë) deputetë, kryesuesja ftoi të njëjtin që të votojnë për kandidatin e propozuar “me ngritje dore”. Në këtë rast, Kryetari i Kuvendit u zgjodh me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, ku 71

(shtatëdhjetë e një) deputetë votuan për, 42 (dyzet e dy) votuan kundër dhe asnjë deputet nuk abstenoj. Po në të njëjtën seancë nënkryetarët e Kuvendit u zgjodhën më shumicë e votave të të gjithë deputetëve përmes votimit të hapur. Në vijim, bazuar në *”Transkriptin e mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 3,4,10,14, 24 gusht dhe më 7 shtator 2017”*, rezulton që në seancën e 7 shtatorit 2017, Kryesuesi “luti deputetët që me ngritje dore” të votojnë kandidatin e propozuar për Kryetar Kuvendi. Si rrjedhojë, 114 (njëqind e katërbëdhjetë) deputetë morën pjesë në votim, ku 62 (gjashtëdhjetë e dy) deputetë votuan për dhe 52 (pesëdhjetë e dy) deputetë votuan kundër. Po në të njëjtën seancë, nënkryetarët e Kuvendit u zgjodhën më shumicë e votave të të gjithë deputetëve përmes votimit të hapur. Tutje, bazuar në *”Transkriptin e mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 26 dhjetor 2019”*, pasi që Kryesuesi konstatoi se të pranishëm ishin 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) deputetë procedoi me kërkesën që deputetët me ngritje dore të deklarohen për kandidatin e propozuar. Kandidati i propozuar për Kryetar Kuvendi në këtë seancë, u zgjodh me shumicë e votave të të gjithë deputetëve, ku 75 (shtatëdhjetë e pesë) deputetë votuan për, 27 (njëzet e shtatë) votuan kundër dhe 6 (gjashtë) deputetë abstenuan. Në po të njëjtën ditë, nënkryetarët e Kuvendit u zgjodhën më shumicë e votave të të gjithë deputetëve përmes votimit të hapur. Në fund, bazuar në *”Transkriptin e mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 22 mars 2021”*, pasi që Kryesuesi konstatoi që të pranishëm ishin 113 (njëqind e trembëdhjetë) deputetë, luti deputetët që me ngritje dore të deklarohen për kandidatin e propozuar për Kryetar të Kuvendit, i cili me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) vota për, 33 (tridhjetë e tre) vota kundër dhe asnjë abstenim u zgjodh Kryetar Kuvendi. Seanca e konstituimit të Kuvendit, përkatësisht ajo e Legjislaturës së VIII-te të Kuvendit përfundoi me zgjedhjen e nënkryetarëve të tij, me shumicë votash të të gjithë deputetëve dhe me votim të hapur.

142. Bazuar në elaborimin si më sipër të zgjedhjes së Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit në legjislaturat III, IV, V, VI, VII dhe VIII, rezulton që mënyra e votimit të kandidatëve për Kryetar dhe nënkryetar të Kuvendit është zhvilluar me votim të hapur.
143. Në vijim të kësaj, dhe në kontekst të interpretimit dhe vlerësimit të Gjykatës në rastin KO124/25 si dhe vlerësimeve të mësipërme, Gjykata, bazuar në paragrafin 1 të nenit 66, nenin 67 dhe nenin 74 të Kushtetutës, konstaton që Kryesuesi i Seancës Konstituive, në mungesë të konsensusit për votim të mbyllur, duhet të kryesojë Seancën konstituive bazuar në Kreun IV të Rregullores së Punës, dhe praktikën e deritanishme parlamentare, duke proceduar me realizmin e pikave të rendit të ditës për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit, përmes mënyrës së njëjtë të votimit, ashtu siç është filluar më 19 prill 2025 dhe vazhduar më 23 prill, 25, 27 dhe 29 prill 2025, përkatësisht përmes votimit të hapur.
144. Më tej, në kuptim të nenit 76 [Rregullorja e Punës] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se deputetët e Kuvendit, respektivisht deputetët e një Kuvendi të konstituuar mund të përcaktojnë, ndryshojnë apo plotësojnë Rregulloren e Kuvendit por gjithmonë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
145. Ndërsa, në kuptim të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese për konstituimin e Kuvendit brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor, Gjykata rithekson që drejta për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit është e ndërlidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me arritjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Gjykata tashmë, ka theksuar që kjo e drejtë për propozimin e kandidatit për Kryetar/e të Kuvendit përbën njëkohësisht edhe detyrim për grupin më të madh parlamentar për bashkëpunim në

mirëbesim dhe konsultim konstruktiv me grupet e tjera parlamentare për të gjetur konsensusin apo kompromisin e nevojshëm dhe se kjo e drejtë në asnjë mënyrë nuk mund të rezultojë në bllokimin e konstituimit të Kuvendit (shih, paragrafin 130 të Aktgjykimit në rastin KO124/25).

146. Para se Gjykata të vijojë me përcaktimet e vazhdimet të Seancës Konstituive, ajo konsideron të nevojshme të sqarojë që bazë për konstituim të Kuvendit mbetet Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KO124/25 së bashku me zgjidhjet procedurale të përcaktuara përmes këtij Aktgjykimi, të cilat burojnë nga pasojat e moszbatimit të afatit kushtetues për konstituimin e Kuvendit dhe afatit të përcaktuar përmes pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit në rastin KO124/25.
147. Gjykata rikujton praktikën e saj gjyqësore, ku në rastin KO 72/20 ajo ka theksuar se *“Kushtetuta e Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi unike e parimeve dhe vlerave kushtetuese mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë shteti i Republikës së Kosovës. Këto parime dhe vlera mishërojnë dhe pasqyrojnë frymën e Kushtetutës, e cila është e transpozuar në secilën normë të saj. Si e tillë, Kushtetuta dhe secila normë e saj duhet të interpretohen në ndërvaresi me njëra tjetrën dhe jo të izoluar nga njëra tjetra, dhe gjithnjë duke pasur parasysh parimet dhe vlerat e saj. Asnjë normë e Kushtetutës nuk mund të interpretohet në mënyrë të ndarë dhe të izoluar nga parimet dhe vlerat e proklamuar në Kushtetutë, përfshirë Preambulën e saj. Asnjë normë kushtetuese nuk mund të nxirret jashtë kontekstit dhe të interpretohet në mënyrë mekanike dhe të pavarur nga pjesa tjetër e Kushtetutës. Kjo për faktin se Kushtetuta ka një kohezion të brendshëm sipas të cilit gjithsecila pjesë ka një ndërlidhje me pjesët e tjera të saj.”* (shih paragrafin 346 të Aktgjykimit KO 72/20 të Gjykatës Kushtetuese).
148. Gjykata kur trajton kushtetutshmërinë e një çështje të ngritur pranë saj, ajo merr për bazë Kushtetutën si tërësi, si dhe dispozitat themelore të saj në Kapitullin I të Kushtetutës, e që interpretohen në lidhshmëri me dispozitat kushtetuese të çështjes së kontestuar. Mbi këtë Gjykata në raste të tilla, trajton kushtetutshmërinë e çështjes në kuptim të sundimit të ligjit dhe interesit të përgjithshëm dhe jo interesave subjektive të ndonjëres nga palët në procedurë.
149. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron që propozimi i vazhdueshëm për votim të kandidatit/es së njëjtë për Kryetar/e të Kuvendit nga ana e grupit më të madh parlamentar nuk duhet të shërbejë si mekanizëm i bllokimit që do të pamundësonte arritjen e shumicës së votave të të gjithë deputetëve. Për këtë qëllim, Gjykata vlerëson që përcaktimi i një mekanizmi deblokues për propozimin e kandidati/es për Kryetar/e të Kuvendit konsiderohet si i domosdoshëm dhe në mënyrë thelbësore do t'i shërbente përmbushjes së detyrimit kushtetues për konstituimin e Kuvendit dhe fillimin e funksionimit të tij si organ përfaqësues i sovranit. Në dritën e këtij elaborimi, Gjykata vlerëson që në rast të dështimit të arritjes së shumicës së votave të të gjithë deputetëve për zgjedhjen e Kryetarit/es të Kuvendit, votimi i kandidatit/es të propozuar për Kryetar/e të Kuvendit mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë.
150. Rrjedhimisht, Gjykata, si autoritet përfundimtar për interpretim të Kushtetutës, bazuar në rrethanat e rastit konkret dhe marrë për bazë që Seanca Konstituive e Kuvendit edhe pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditor të përcaktuar me Kushtetutë nuk ka përfunduar, konstaton që votimi i një kandidati/eje të njëjtë për Kryetar/e të Kuvendit nuk mund të realizohet më shumë se 3 (tre) herë. Kufizimi në 3 (tre) raunde votimi për të njëjtin kandidat, duke u bazuar në frymën e Kushtetutës dhe zgjedhjen e krerëve të institucioneve,

është mekanizëm mbrojtës që siguron që vullneti i qytetarëve i shprehur përmes zgjedhjeve parlamentare të mos manifestohet në një boshllëk institucional shtetëror, por të jetësohet përmes konstituimit të Kuvendit si ushtrues i sovranitetit dhe si organ me kompetenca legjislative dhe mbikëqyrëse.

151. Gjykata këtë konstatim e ndërlihd edhe me përcaktimet kushtetuese dhe ligjore lidhur me votimin e krerëve të institucioneve tjera nga ana e Kuvendit (shih, nenin 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës dhe nenin 9 (Zgjedhja e Avokatit të Popullit) të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit), proces i cili zhvillohet brenda një afati të përcaktuar dhe përmes një numri të arsyeshëm të raundeve të votimit. Prandaj, Gjykata vlerëson që kufizimi i mundësisë së votimit të të njëjtit/es kandidat/e për Kryetar/e të Kuvendit deri në 3 (tre) herë konsiderohet si një mekanizëm dhe mundësi që deputetët e zgjedhur, në frymën e bashkëpunimit konstruktiv të në frymën e ushtrimit të mandatit të tyre kushtetues sipas përcaktimeve të Kushtetutës të arrijnë që realizojnë detyrimet e tyre kushtetuese për zgjedhjen e Kryetarit/es të Kuvendit.
152. Në kuptim të konstatimeve të dhëna në Aktgjykimin KO 124/25 lidhur me afatin 30 (tridhjetë) ditë të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës si dhe të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga neni 67 dhe 74 të saj, si dhe në kuptim të konstatimeve të nxjerra si në këtë Aktgjykim në rastin KO193/25 dhe KO196/25, Gjykata rithekson se “[...] *“Në kontekst të konstituimit të institucioneve shtetërore, Gjykata ka theksuar që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlihdet me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo të bllokojë themelimin e institucioneve dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre, sepse vetëm në atë mënyrë mund të zbatohet drejt parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutën (shih, rastin KO 72/20, parashtrues Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24 / 2020, i 30 prillit 2020, paragrafi 475)”*. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se ky rregull përcaktohet mbi bazën e parimit kushtetues të rikonfirmuar nga Gjykata përmes praktikës gjyqësore të saj, përkatësisht parimin që qëllimi i normave kushtetuese është funksionimi i institucioneve. Në kontekst të kësaj, Gjykata vlerëson se Kuvendi në të ardhmen mund të iniciojë plotësimin e normativës ligjore përkritazi me konstituimin e Kuvendit përmes Rregullores së tij të Punës, por që deri në ndryshimin e kësaj të fundit, vlejnë zgjidhjet procedurale të dhëna përmes këtij Aktgjykimi.
153. Andaj, në mungesë të një Kuvendi të konstituuar të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese si autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, vëren se në frymën e përcaktimeve kushtetuese në nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], neni 7 [Vlerat], neni 16 [Epërsia e Kushtetutës], neni 63 [Parimet e Përgjithshme], neni 65 [Kompetencat e Kuvendit], neni 66 [Zgjedhja dhe Mandati], neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], neni 70 [Mandati i Deputetëve], neni 74 [Ushtrimi i Funksionit], dhe nenin 76 [Rregullorja e Punës] rrjedh qartë se qëllimi i tyre është jetësimi dhe funksionalizimi i Kuvendit si organ përfaqësues i popullit.
154. Në kuptim të përcaktimit të detyrimeve për deputetët e zgjedhur në konstituimin e Kuvendit si pasojë e përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditë të përcaktuar në pikën II të paragrafit 2 të dispozitivit të Aktgjykimit në rastin KO124/25 brenda të cilit Kuvendi nuk ka arritur të konstituohet, Gjykata sërish vë theksin në përgjegjësinë e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit që veprimet e tyre duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën

e saj dhe të njëjtit të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin.

155. Gjykata vë rëndësi thelbësore në rrethanat e një Kuvendi të pakonstituuar, i cili nuk mund të ushtrojë kompetencat e tij legislative, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse, në veçanti pamundësinë e tij për të zgjedhur Qeverinë dhe institucionet kushtetuese që burojnë nga vendimmarrja e Kuvendit, rrethana të cilat kanë rezultuar në ekzistimin e mëtejshme të një Qeverie në detyrë me kompetenca të kufizuara dhe pa mbikëqyrje të Kuvendit, rrethana të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë afektojnë funksionimin e mirëfillt të rendit kushtetues në kuptim të neneve 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
156. Bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata konsideron që në interes të ruajtjes së rendit kushtetues dhe funksionimit efektiv të institucioneve kyçe shtetërore në kuptim dhe me qëllim të jetësimit të përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 66, paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 67 dhe nenit 74 të Kushtetutës, deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të vazhdojnë Seancën Konstituive të Kuvendit, të filluar më 15 prill e cila duhet të përfundojë me zgjedhjen e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij. Thënë këtë, Gjykata konsideron që detyrimet e deputetëve që burojnë nga paragrafi 1 i nenit 66, paragrafëve 2, 3 dhe 4 të nenit 67 dhe nenit 74 të Kushtetutës, duhet të zbatohen dhe të zhvillohen ashtu siç kanë filluar më 15 prill dhe janë vazhduar deri më 29 prill 2025, në pajtim me Kreun IV të Rregullores së Kuvendit dhe praktikës së deritanishme parlamentare për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit sa më shpejt dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi.
157. Në vijim dhe në kuptim të zhvillimit të procedurës së konstituimit të Kuvendit, e cila sipas konstatimeve të këtij Aktgjykimi duhet të vazhdojë me pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, Gjykata rikujton që Kryesuesi i Seancës mbajtjen dhe zhvillimin e procedurës së Seancës konstituive duhet ta realizojë në pajtim me detyrimet e përcaktuar me Kushtetutë, Kreun IV të Rregullores së Punës dhe përcaktimet e këtij Aktgjykimi. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se thirrja dhe mbajtja e Seancës Konstituive, në rast të përpjekjeve për zgjedhje të Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit duhet të realizohet në përputhje me detyrimet e përcaktuara me Kushtetutë, Kreun IV të Rregullores së Punës dhe konstatimeve të këtij Aktgjykimi. Në vijim të kësaj, dhe në kuptim të përpjekjeve të vazhdueshme të Kuvendit për zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve brenda afatit 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, Gjykata rikujton rëndësinë e asaj që Kryesuesi i Seancës Konstituive mbajtjen e seancës konstituive duhet ta realizojë në pajtim me paragrafin 5 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton që *“Ndërrprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.”*
158. Gjykata në kuptim të detyrimeve të deputetëve për realizimin e Seancës Konstituive rithekson që zgjedhja e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit është parakusht që Kuvendi të fillojë të funksionojë, dhe në kontekst të përcaktimeve të neneve 4, 7 dhe 74 të Kushtetutës, kjo kërkon nga të gjithë deputetët e zgjedhur që gjatë votimit të kandidatëve për Kryetar/e dhe nënkryetarë të Kuvendit të jenë të pranishëm dhe të votojnë. Gjykata rithekson që në rrethanat e rastit konkret, nuk ka interes më të mirë të Republikës së Kosovës, se sa konstituimi i organit më të lartë përfaqësues.
159. Gjykata rithekson që në rrethanat e rastit konkret, ushtrimi i funksionit të deputetëve të zgjedhur në pajtim me këtë Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit që

rezulton në zgjedhjen e Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit është në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës, dhe i shërben ruajtjes së rendit kushtetues dhe garantimit të funksionimit të institucioneve. Si rrjedhojë, Gjykata sërish nënvizon se nuk ka interes më të mirë të Republikës së Kosovës, se sa organi më i lart përfaqësues të jetë i konstituuar dhe të fillojë sa më parë me funksionimin e tij dhe ushtrimin e kompetencave dhe detyrimeve të tij kushtetuese.

160. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton që Kryesuesi i Seancës Konstituive duhet të vazhdojë me pikën 3 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, të miratuar më 8 prill 2025, dhe në pajtim me paragrafin 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës, të ftojë përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i/e cili/cila zgjedhet përmes votimit të hapur, votimi i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim përcakton që deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të zgjedhin Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës të Seancës Konstituive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 46 (4) dhe 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 7 gusht 2025, vendosi:

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e 26 qershorit 2025, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO124/25, dhe rrjedhimisht të gjitha seancat e mbajtura nga data 27 qershor deri më 26 korrik 2025 shpallen të pavlefshme;
- III. TË KONSTATOJË, njëzëri, që Kryesuesi i Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO124/25, të 26 qershorit 2025 dhe rrjedhimisht veprimet e tij janë në papajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- IV. TË URDHËROJË, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, Kryesuesin e Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës të vazhdojë me pikën 3 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, të miratuar më 8 prill 2025, dhe në pajtim me paragrafin 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të ftojë përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i/e cili/cila zgjedhet përmes votimit të hapur, votim i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë;
- V. TË URDHËROJË, njëzëri të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë procedurës së zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të jenë të pranishëm dhe të votojnë;

- VI. TË URDHËROJË, me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të zgjedhin Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës të Seancës Konstituive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VII. TË VAZHDOJË, njëzëri, masën e përkohshme të vendosur më 24 korrik 2025 deri në hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VIII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- IX. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- X. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit të tij nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe njoftimit të palëve.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljatifi

Nexhmi Rexhepi